Strategjia nacionale për drogat e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2025

me Planin për veprim 2021-2023

Ministria e shëndetësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

STRATEGJIA NACIONALE PËR DROGAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT 2021-2025 ME PLANIN PËR VEPRIM 2021-2023

maj 2021

Ministria e shëndetësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në përpunimin e Strategjisë nacionale për drogat 2021-2025 me Planin e veprimit 2021-2023 morrën pjesë anëtarë të Komisionit ndërsektoral për drogat dehëse dhe ekspertë të Grupit punues të formuar nga Ministri i shëndetësisë i cili përfshinte përfaqësues nga:

- Ministria e shëndetësisë,
- Ministria e punëve të brendshme,
- Ministria e financave_Drejtoria doganore,
- Ministria për arsim dhe shkencë,
- Ministria për punë dhe politikë sociale,
- Ministria e punëve të jashtme,
- Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave,
- Ministria e drejtësisë,
- Ministria për vetëqeverisje lokale,
- Agjencia për të rinjtë dhe sportin,
- Instituti i shëndetit publik Shkup,
- Sektori për mbrojtje sociale i Qytetit të Shkupit,
- Spitali psikiatrik "Shkupi" – Qendër ditore për trajtim të sëmundjeve nga varshmëritë "Kisella Vodë"
- Spitali i përgjithshëm i qytetit "8 shtatori" Shkup- Qendra ditore për terapi me metadon,
- IPSh Helio medika- Shkup,
- Shoqata Izbor Strumicë
- Shoqata Doverba Shkup,
- Shoqata HOPS-Opcione për jetë të shëndetshme Shkup
- Rrjeti i organizatave jo-qeveritare aktive në fushën e drogave

Përkthyes: Lindita Bilal-Abdullahu

Dizajni dhe shtypi Polyesterday DOO Shkup

Tirazhi 50

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

613.83:005.21(497.7)"2021/2025"
364.692:178.8(497.7)"2021/25"
343.575(497.7)"2021/25"

STRATEGJIA nacionale për drogat e Republikës së Maqedonisë së Veriut
: 2021-2025 : me Planin për veprim 2021-2023 / [përkthim nga gjuha maqedonase Lindita Bilal-Abdullahu]. - сккуп : HOPS opsione për jetë të shëndetshme, 2021. - 37, 33 стр. : граф. прикази, табели ; 21 см

Превод на делото: Национална стратегија за дроги на Република Северна Македонија : 2021-2025 : со Акциски план 2021-2023.
- Фусноти кон текстот. - Содржи и: Plan i veprimit për periudhën 2021-2023 për zbatimin e strategjisë nacionale për drogat

ISBN 978-608-4701-51-4

а) Дроги -- Стратегија -- Македонија -- 2021-2025

COBISS.MK-ID 56000517

Ky botim është mundësuar me mbështetjen financiare të Fondit global për luftë kundër HIV/SIDA, tuberkulozit dhe malaries, në kuadër të projektit rajonal "Qëndrueshmëria e shërbimeve për popullatat kryesore në rajonin e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore" i realizuar nga Shoqata HOPS-Opsione për jetë të shëndoshë Shkup.

Mirënjohje

Falenderojmë të gjitha ministritë, institucionet, shoqatat e qytetarëve dhe ekspertët që morën pjesë në takimet e grupit të punës dhe që me ekspertizën dhe përvojën e tyre kontribuan në përgatitjen e kësaj strategjie nacionale për drogat dhe Plani i veprimit. Falënderime të veçanta për kryetaren e Komisionit ndërsektoral për droga të Republikës së Maqedonisë së Veriut Lidija Saviq, HOPS-Opsione për jetë të shëndoshë Shkup dhe lehtësuesit Elizabeta Markovska Spasenoska dhe Tomislav Gajtanoski për mbështetjen dhe ndihmën e përgjithshme gjatë gjithë procesit.

Shkup, dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE 5

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 6

HYRJE 8

1. ANALIZA E SITUATËS NË FUSHËN E DROGAVE 9

1.1 Tendencat e përgjithshme në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar 9

1.2 Analiza e problemeve dhe nevojave 12

2. TEORIA E NDRYSHIMIT 23

3. PRIORITETET STRATEGJIKE, SYNIMET, REZULTATET DHE MASAT 25

Prioriteti strategjik 1:
Ulja e kërkesës për droga 25

Prioriteti strategjik 2:
Reduktimi i ofertës së drogave 27

Prioriteti strategjik 3:
Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i koordinimit dhe komunikimit ndërmjet institucioneve kompetente në përputhje me praktikat dhe standardet e mira 28

4. KORNIZA LIGJORE DHE DOKUMENTET STRATEGJIKE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË 30

5. INSTITUCIONET, AKTORËT DHE PËRDORUESIT PËRFUNDIMTARË NË POLITIKAT KOMBËTARE PËR DROGA 30

6. KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË STRATEGJISË ME PUBLIKUN 31

7. BURIMET E FINANCIMIT 32

PLAN I VEPRIMIT PËR PERIUDHËN 2021-2023 PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NACIONALE PËR DROGAT 33

LISTA E SHKURTESAVE

APRMV	Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut
The GPS of Drugs	Përdorimi i substancave psikoaktive tek popullata e përgjithshme në Republikën e Maqedonisë, Raport nga hulumtimi
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
EMCDDA- (European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction)	Qendra Evropiane e monitorimit e drogës dhe varësitë nga drogat
ESPAD (European School Survey Project on Alcohol and Other Drugs)	Projekti Evropian për hulumtim në shkollat mbi alkoolin dhe drogat
ISHP	Instituti i shëndetit publik
KP	Persona që injektojnë drogën
PID	Persona që përdorin droga
PPD	Persona me çregullime nga përdorimi i drogave
PÇPD	Луѓе со нарушување од употреба на дроги
MASH	Ministria e arsimit dhe shkencës
MSH	Ministria e shëndetësisë
MPB	Ministria e punëve të brendshme
MPPS	Ministria për punë dhe politikë sociale
QNPTVD	Qendra nacionale për parandalim dhe trajtim të varësisë nga droga
TP	Tregtia e paligjshme
TOA	terapi opioid agonistike
GOK	Grupe të organizuara kriminale
PRD	Programi për reduktimin e dëmeve
SPA	Substanca psikoaktive
RMV	REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetit
KB (UN-United Nations)	Kombet e Bashkuara
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për drogën dhe krimin
HIV	Virusi i imunodeficiencës njerëzore
HOPS - OJQ HOPS	Opsione për jetë të shëndetshme
DD	Drejtoria doganore

Terminologjia

Persona me çrregullime nga përdorimi i drogës – Termi është në përputhje me standardet e OBSh-së. Ai do të përdoret kudo në tekst, me përjashtim të pjesëve që citohen dhe ku fillimisht janë përdorur terma si të varur, i varur, përdorues etj.

Për kanabisin, marihuanën dhe kërpi si term i përbashkët do të përdoret **kanabisi**. Duke vepruar kështu, forma origjinale e termave të tjerë të përmendur si marihuanë ose kërp do të ruhet në ato vende ku citohen raportet dhe dokumentet.

OShC janë shoqata, fondacione, sindikata, si dhe çdo formë organizative e një organizate të huaj, si dhe forma të tjera të asociimit, të regjistruara në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia nacionale për droga (në tekstin e mëtejmë Strategjia për droga) mbulon periudhën strategjike 2021-2025 dhe bazohet në prioritetet dhe synimet e vërtetuara në Strategjinë Evropiane mbi drogën, si dhe në analizat dhe rekomandimet e dhëna nga EMCDDA dhe institucionet kombëtare përgjegjëse për fushën e drogave. Analiza e strategjisë së mëparshme evidentoi nevojën për forcimin e mëtejshëm dhe zhvillimin e qasjeve adekuate për reduktimin e kërkesës dhe ofertës së drogave si dhe nevojën për një koordinim të përforcuar ndërmjet institucioneve dhe përmirësim të sistemit të raportimit. Bazuar në tendencat e përdorimit të drogës tek popullata dhe veçanërisht tek të rinjtë, u evidentua nevoja për një qasje sistematike për parandalim përmes procesit arsimor në të gjitha nivelet. Është gjithashtu e nevojshme të përshtaten programet e trajtimit për personat me çrregullime të përdorimit të drogës (PÇPD) sipas specifikave dhe nevojave të atyre personave, si dhe njohja dhe përfshirja e programeve për reduktim të dëmeve nga përdorimi i drogave në strategjinë e përgjithshme të menaxhimit me politikat e drogës. Nga analiza rezultoi se nevojitet forcimi i mëtejshëm i personelit në të gjitha institucionet që punojnë për uljen e kërkesës dhe ofertës së drogave, si dhe pajimi teknik dhe akreditimi i laboratorëve në përputhje me trendet bashkëkohore në këtë fushë. Rëndësi të veçantë ka ekuipimi kadrovik dhe teknik i Qendrës për droga dhe koordinimi i përforcuar për një qasje të vetme në menaxhimin e politikave të drogës.

Në këtë drejtim, në periudhën e ardhshme strategjike janë përcaktuar këto ndryshime kryesore të pritshme dhe synimet që duhen arritur:

FUSHA – ZVOGËLIM I KËRKESËS PËR DROGA

Ndryshimi i pritur: Zvogëlimi i numrit të të rinjve që përdorin drogë, mbulim më i madh i PPD përmes programeve për trajtim dhe kujdes, PRD, risocializim, rehabilitim dhe riintegrim, ulje e numrit të PPD dhe PID, dhe me këtë ulje e kërkesës për droga.

Qëllimi strategjik 1.1: Krijimi i një sistemi efektiv për parandalim të drogave në kuadër të arsimit dhe shëndetësisë në përputhje me praktikat e mira

Qëllimi strategjik 1.2: Programe cilësore për trajtim nga drogat që përfshijnë të gjithë personat sipas gjinisë, moshës dhe llojit të drogës që ata përdorin

Qëllimi strategjik 1.3: Programet për reduktim të dëmit nga përdorimi i drogës janë përmirësuar, janë të qëndrueshme dhe të përshtatura me nevojat e përdoruesve

Qëllimi strategjik 1.4: Qasje e përmirësuar e përdoruesve e shërbimeve sociale në nivel lokal

FUSHA - REDUKTIMI I OFERTËS SË DROGAVE

Ndryshimi i pritur: Veprim efikas dhe efektiv i gjykatave, prokurorive publike dhe institucioneve përgjegjëse për reduktimin e tregtisë së palejuar të drogës, gjë që çon në uljen e ofertës së drogës.

Qëllimi strategjik 2.1: Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit penal në lidhje me sanksionimin e autorëve të krimeve që lidhen me trafikun e paligjshëm dhe prodhimin e paautorizuar të drogave

Qëllimi strategjik 2.2: Përmirësimi i funksionalitetit të institucioneve përgjegjëse për parandalimin e tregtisë së palejueshme me drogë

Qëllimi strategjik 2.3: Përmirësimi i praktikave të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për parandalimin e tregtisë së palejuar me drogë

FUSHA - ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I KAPACITETEVE DHE PËRMIRËSIMI I KOORDINIMIT DHE KOMUNIKIMIT NDËRMJET INSTITUCIONEVE KOMPETENTE NË PËRPUTHJE ME PRAKTIKAT DHE STANDARDET E MIRA

Ndryshimi i pritur: Përgjigje efektive nga institucionet në trajtimin e problemit të drogës në RMV dhe respektimi i praktikave dhe standardeve të mira në këtë fushë.

Qëllimi strategjik 3.1: Funksionalitet i përmirësuar i sistemit të menaxhimit të politikave për droga

Qëllimi strategjik 3.2: Përmirësimi i cilësisë së sistemit të raportimit tek institucionet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe publikut

Qëllimi strategjik 3.3: Rritja e burimeve financiare për zbatimin e politikave dhe programeve për drogë

Në periudhën e ardhshme, Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV) do të ketë për detyrë të harmonizohet me praktikat dhe standardet e mira në kuadër të fillimit të pritshëm të negociatave në përputhje me metodologjinë e re. Në atë proces, rëndësi të veçantë ka mbështetja për zbatimin e kësaj strategjie nga ana e të gjitha institucioneve kompetente si dhe konsultimi i strategjisë në përgatitjen e politikave dhe dokumenteve strategjike në fushat që lidhen ngushtë me politikat e drogës.

HYRJE

Në periudhën shtator-dhjetor 2020, grupi i punës për përgatitjen e Strategjisë për Droga zhvilloi një proces me pjesëmarrje për përgatitjen e një dokumenti gjithëpërfshirës. Në përgatitjen e Strategjisë për droga, përveç anëtarëve të Komisionit ndërinstitucional për droga, janë përfshirë edhe përfaqësues të shoqatave të qytetarëve, përfaqësues të PPD, si dhe përfaqësues të institucioneve të caktuara nga sektori publik dhe privat.

Përgatitja e Strategjisë për droga u realizua përmes një sërë punëtorish në të cilat u bë analiza e situatës aktuale, analiza e trendeve në Evropë, trendeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, analiza e problemeve dhe nevojave me të cilat ballafaqohen si politikëbërësit për drogat ashtu edhe PPD dhe shoqatat civile. Në përgatitjen e strategjisë është përdorur metodologjia Teoria e ndryshimit , e cila fokusohet në përcaktimin e ndryshimeve realiste pozitive në afat të shkurtër dhe afat të gjatë, bazuar në parakushtet dhe supozimet e vendosura për mbështetjen, burimet dhe kuadrin legjislativ të nevojshëm për zbatimin e qëllimeve dhe masave të përcaktuara.

Strategjia Evropiane për Drogën dhe Plani i Veprimit 2021-2025, janë përdorur si drejtimi kryesor në zhvillimin e synimeve dhe masave të Strategjisë për droga, por edhe një sërë dokumentesh kombëtare në këtë fushë, siq janë raportet përkatëse nga ministritë dhe institucionet e tjera të përfshira, strategjitë dhe programet e tyre si dhe analiza të segmenteve të ndryshme të përfshira në strategjinë e përgatitur nga organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu, në planifikimin e periudhës së re strategjike, grupi i punës iu referua vlerësimit të kryer të strategjisë së mëparshme për droga 2014-2020. Sipas gjetjeve nga evaluimi[1], konkluzioni kryesor nga zbatimi i Strategjisë së mëparshme nacionale për droga është se ajo është zbatuar pjesërisht, pra se shumica e aktiviteteve të parashikuara në planet e veprimit janë zbatuar pjesërisht. Gjithashtu, një nga konkluzionet më të rëndësishme është mungesa e mbështetjes dhe vullnetit politik për zbatimin e strategjisë së mëparshme si dhe konsultimi i pamjaftueshëm i strategjisë së mëparshme në proceset e planifikimit dhe zbatimit të programeve të institucioneve. Në kuadër të këtij vlerësimi, është evidentuar nevoja për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në planifikimin dhe zbatimin e strategjisë për droga si dhe përfshirja e perspektivës së PPD dhe PÇPD në proceset e planifikimit të politikave të drogës. Gjithashtu, është bërë analiza e cilësisë së programeve për trajtim[2], sipas së cilës është e nevojshme të përmirësohet situata sipas të gjitha standardeve të vendosura për cilësinë e trajtimit, pra më konkretisht të përmirësohet qasja dhe disponueshmëria e trajtimit, standardet etike, koordinim ndërmjet institucioneve, bazuar në dëshmi shkencore, përshtatje me nevojat e nëngrupeve specifike, menaxhim i mirë i shërbimit klinik, monitorim dhe vlerësim i politikave.

Strategjia nacionale për drogat miratohet për të shërbyer si bazë për veprimin e autoriteteve shtetërore, organeve të njësive të vetëqeverisjes lokale, institucioneve, shoqatave dhe bashkësive fetare dhe grupeve fetare si dhe personave të tjerë juridikë dhe fizikë.

Strategjia nacionale për drogat bazohet në parimet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për sigurinë e garantuar të të gjithë qytetarëve, për mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, për qasje të barabartë dhe të balancuar të qytetarëve, për përshtatje të nevojave grupeve të ndryshme të synuara, për përgjegjësi të ndarë dhe qasje të koordinuar dhe ekonomike.

1 Evaluimi i Strategjisë Nacionale për droga 2014-2020, V. Dekov, I. Cvetkoviq, qershor 2020 (Vlerësim i strategjisë kombëtare të drogave)..
2 Raport për vlerësimin e standardeve minimale për cilësinë e programeve të trajtimit të drogës në Republikën e Maqedonisë.

1. ANALIZA E SITUATËS NË FUSHËN E DROGAVE

1.1 Tendencat e përgjithshme në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar

Sipas të dhënave të vitit 2019, të paraqitura në **Raportin Evropian për droga**[3], shumica e treguesve për substancat e përdorura zakonisht sugjerojnë se disponueshmëria e drogave mbetet e lartë. Rreth 96 milionë të rritur kanë përdorur droga të paligjshme. Roli i kokainës në problemin e drogës në Evropë po rritet. Numri dhe sasia e konfiskimeve të kokainës tani janë më të lartat që kanë qenë ndonjëherë, me mbi 181 ton drogë të sekuestruar në vitin 2018. Përdorimi i kokainës krek, megjithëse ende jo shumë i zakonshëm, po raportohet gjithnjë e në më shumë vende. Brengos potenciali për rritjen e përdorimit të heroinës dhe dëmeve të vazhdueshme nga ajo. Por numri i personave të rinj që trajtohen për heroinë po bie në shumë vende. Kanabisi është arsyeja më e zakonshme për pranim për trajtim të varësisë. Drogat ekzistuese dhe të reja vazhdojnë të prodhohen në Evropë, për tregjet globale dhe lokale, me më shumë laboratorë dhe pika prodhimi të zbuluara nga shërbimet. Disponueshmëria e vazhdueshme e MDMA (ekstazi) me potencial të lartë kërkon ndërgjegjësim më të madh tek PPD. Nevojitet një kuptim më i mirë i disponueshmërisë së substancave si të atyre të kontrolluara ashtu edhe të substancave më pak të zakonshme dhe ndikimi i tyre në shëndetin publik. Mbidozimi me droga po shoqërohet gjithnjë e më shumë me përdoruesit më të moshuar. Injektimi i drogës mbetet kanali kryesor për infeksionet me hepatit C në Evropë dhe për këtë arsye qasja e personave që injektojnë drogë në parandalimin, testimin dhe trajtimin e hepatitit C është vendimtar për eliminimin e kësaj sëmundjeje. Substancat e reja psikoaktive janë bërë një problem i vazhdueshëm. Në fund të vitit 2019, EMCDDA ndiqte rreth 790 substanca të reja psikoaktive, nga të cilat 53 janë raportuar për herë të parë në Evropë. Shfaqja e opioideve të reja sintetike është shqetësuese përsa i përket përshtatjes së vazhdueshme në treg. Tregje të mëdha për kanabis, heroinë dhe amfetamina kanë ekzistuar në Evropë që nga vitet 1970. Me kalimin e kohës, substanca të tjera janë vendosur në tregje, duke përfshirë MDMA dhe kokainën që nga vitet 1990. Tregu evropian i drogës vazhdon të evoluojë me një gamë të gjerë të substancave të reja psikoaktive që janë shfaqur në dekadën e fundit. Ndryshimet e fundit në tregun e drogave të paligjshme, që kanë të bëjnë me globalizimin dhe teknologjinë e re, përfshijnë inovacionin në prodhimtarinë e drogave dhe metodave të tregtisë, krijimin e rrugëve të reja për lëvizje dhe rritje të tregjeve virtuale në internet. Zinxhiri i furnizimit me droga është më i lidhur globalisht dhe i mbështetur në mënyrë digjitale, duke rezultuar në tregje të drogës që po inovojnë me shpejtësi dhe po eksplorojnë mundësi të reja. Në vitin 2019, ka më shumë se një milion sekuestrime të drogave të paligjshme ku dominon kanabisi. Në vitin 2018, në BE ka një vlerësim për 966 persona të rinj të diagnostikuar me HIV, të cilët mund të lidhen me përdorimin e drogës me injektim. Mbidozimi është shkaku më i shpeshtë i vdekjes tek përdoruesit e drogës me rrezik të lartë.

Për sa i përket **tendencave në Republikën e Maqedonisë së Veriut**, sipas Raportit të Institucionit për shëndetin publik (IShP) për përdorimin e drogave midis popullatës së përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2017, mund të veçohen tendencat në vijim:

Prevalenca e përdorimit të drogave

Në nivel të gjithë popullsisë, 8,9% kanë përdorur drogë kurdo në jetën e tyre, 6,9% kanë përdorur drogë të paktën një herë në vitin e kaluar, ndërsa 4,3% kanë deklaruar se kanë përdorur drogë të paktën një herë në muajin e kaluar.

Mosha	Kurdoherë në jetë	Vitin e kaluar	Muajin e kaluar
15-24	18,9 %	15,4 %	10,8 %
25-34	14,1 %	10,6 %	6,1 %

3 European Drug Report, në dispozicion në: https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/13236/TDAT20001ENN_web.pdf

35-44	5,5 %	3,3 %	1,8 %
45-54	0,1 %	0,8 %	0,1 %
55-64	0,1 %	0,0 %	0,0 %

Tabela nr. 1

Prevalenca më e lartë në përdorimin e drogës është në grupmoshën 15 deri në 24 vjeç për sa i përket tre kritereve për përdorim të drogave. Për sa i përket përdorimit të drogës kurdoherë në këtë grup janë të përfshirë 18.9%, për sa i përket përdorimit në vitin e kaluar, në këtë grup janë të përfshirë 15.4%, ndërsa për sa i përket përdorimit të drogës në muajin e kaluar 10.8% përfaqësohen në këtë grup. Pas këtij grupi vijon grupi i moshës nga 25 deri në 34 vjeç.

Llojet e drogave të përdorura

Droga më e përdorur në popullatë që e kurdo herë në jetë ka përdorur drogë të paktën një herë është kanabisi dhe është më së shpeshti e përdorur tek popullata e re e moshës 15 deri në 34 vjeç. Tek ata që kanë përdorur drogën në vitin e kaluar, droga e dytë më e përdorur është ekstazi, në grupin që ka përdorur drogë të paktën një herë në muajin e kaluar, droga e dytë më e përdorur është heroina.

Mosha	Kanabis	Ekstazi	Amfetamina	Kokaina	Heroina	LSD
Përdorimi i drogës kurdo herë në jetë						
15-64	8,2 %	1,6 %	1,1 %	1,3 %	1,1 %	0,5 %
15-34	15 %	2,8 %	2,1 %	2,5 %	1,7 %	1 %
Përdorimi i drogës të paktën një herë në vitin e kaluar						
15-64	6,6 %	0,8 %	0,6 %	0,9 %	0,8 %	0,3 %
15-34	12,5 %	1,6 %	1,3 %	1,8 %	1,5 %	0,5 %
Përdorimi i drogës të paktën një herë në muajin e kaluar						
15-64	4,1 %	0,4 %	0,4 %	0,4 %	0,7 %	0,2 %
15-34	8 %	0,8 %	0,8 %	0,9 %	1,3 %	0,3 %

Tabela nr. 2

Mosha në kohën e përdorimit të drogës për herë të parë

Mosha mesatare e popullsisë së përgjithshme kur për herë të ka përdorur kanabis është 17.8 vjeç. Sa i përket drogave të tjera , mosha më e ulët prej 13 vjeç e më pak kur kanë përdorur drogën për herë të parë i referohet përdorimit të kokainës dhe ekstazisë, përkatësisht 9.7% dhe 8.1%.

	≤13	14-15	16-17	18-19	20-21	22-23	24-25	≥ 26
Ekstazi	8,1 %	32,7 %	28,3 %	16,9 %	9,6 %	0 %	4,5 %	0 %
Amfetamina	1,9 %	7,9 %	24,8 %	51,8 %	9,1 %	4.5 %	0 %	0 %
Kokaina	9,7 %	2,8 %	14,6 %	29,3 %	20 %	10,4 %	8,3 %	4,8 %
Heroina	0 %	3,9 %	11,8 %	42,6 %	20,1 %	4,2 %	3,9 %	13,3 %
LSD	0 %	14,4 %	8,5 %	53,6 %	8,7 %	0 %	0 %	14,9 %

Tabela nr. 3

Qasja deri te droga

Shumica e të anketuarve të moshës 15 deri në 64 vjeç mendojnë se do të ishte shumë e vështirë dhe thuajse e pamun-

dur të qasen deri te droga, ndërsa 33,1% mendojnë se prë ta do të ishte shumë e lehtë ose e lehtë për tu qasur tek droga

Substanca të reja

Prevalenca e përdorimit të substancave të reja mbetet relativisht e ulët në 0.6%.

Sipas **Raportit për përdorim të alkoolit, cigareve dhe drogës tek të rinjtë shkollorë** në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 2015, treguesit kryesorë janë si në vijim:

Marihuana (kanabisi)	1999	2008	2015	2019
Përdorimi i marihuanës në jetë	4,5 %	5,5 %	5 %	6,1 %
Përdorimi i marihuanës në 12 muajt e fundit	/	4 %	3,9 %	4,8 %
Përdorimi i marihuanës në 30 ditët e fundit	1,3 %	2,2 %	2,2 %	2,7 %

Tabela nr. 4

Përdorimi i marihuanës si prevalencë jetësore tek popullata e re tregon ndryshime të parëndësishme sipas të dhënave edhe nga hulumtimet e mëparshme, pra 4.5% në 1999, 5.5% në 2008, 5% në 2015. dhe një rritje e lehtë në 6.1% në 2019. Për sa i përket përdorimit të marijuanës në 30 ditët e fundit- edhe ketu tendenca këtu mbetet relativisht e qëndrueshme me 1.3% të regjistruara në 1999, 2.2% në 2008 dhe 2015 dhe një rritje e lehtë prej 2.7% në 2019.

Substanca të tjera psikoaktive (përdorimi kurdo herë në jetës)	2015	2019
Përdorimi i ekstazi	2,1 %	1,1 %
Përdorimi i inhaluesve në jetë	1,9 %	1,9 %
Përdorimi i amfetaminës	1,4 %	0,6 %
Përdorimi i kokainës	1,5 %	0,9 %
Përdorimi i krek	0,9 %	0,2 %
Përdorimi i heroinës	0,9 %	0,5 %
Përdorimi i kërpudhave magjike	0,6 %	0,5 %
Përdorimi i GHB	0,7 %	0,2 %
Përdorimi i steroideve anabolike	0,6 %	0,6 %
Përdorimi i drogave që përdoren me anë të shiringës	0,8 %	0,5 %
Përdorimi i analgjezikëve për të qenë "high"	4,2 %	2,0 %
Përdorimi i njëkohshëm i alkoolit dhe analgjezikëve	2,8 %	1,6 %

Tabela nr. 5

Sipas të dhënave nga hulumtimi në vitin 2019, përqindja e nxënësve që kanë përdorur lloje të tjera të drogës gjatë jetës së tyre varion nga 0,5% për kërpudhat magjike, 0,6% për steroidet anabolike, 0,8% për LSD dhe 0,5% për heroinën.

Nëse krahasojmë rezultatet e këtij studimi ESPAD me rezultatet e studimeve të mëparshme, përdorimi i heroinës dhe LSD-së është në një rënie të lehtë ndërsa steroidet anabolike janë në stagnim. Rritje në përdorimin e kokainës shënohet në periudhën prej 2008-2015 (0.9% në vitin 2008 dhe 1.5% në 2015), ndërsa në vitin 2019 ka sërish një rënie tek përdorimi i kokainës në 0.9%. Në vitin 2019, 2,2% e nxënësve janë përgjigjur se kanë përdorur substanca të reja që imitojnë efektin e drogave të paligjshme, që është një rënie në krahasim me vitin 2015, kur 3,7% e nxënësve kanë raportuar se kanë përdorur substanca të reja.

1.2 Analiza e problemeve dhe nevojave

Fusha: Kërkesa e drogave

Parandalimi i përdorimit të drogave: Parandalimi i përdorimit të drogave në uadër të sistemit të shëndetësisë bëhet kryesisht përmes veprimtarisë së mjekëve profesionistë nga institucionet shëndetësore të cilët herë pas here sipas një plani të caktuar mbajnë ligjërata dhe edukim për këto tema në shkollat fillore dhe të mesme. Mund të thuhet se problemi i edukimit sistematik jo vetëm të të rinjve, por edhe të stafit pedagogjik është i pranishëm prej kohësh ndërsa në strategjinë e mëparshme mbetet e parealizuar mu kjo pjesë e parandalimit në kuadër të arsimit. Megjithëse ekzistojnë aktivitete edukative të izoluara, por të vazhdueshme dhe për momentin të përhershme që zhvillohen nga organizatat e shoqërisë civile në këtë fushë ose nga organizatat rinore, ato janë të pamjaftueshme dhe nuk mbulojnë të gjithë sistemin arsimor. Me anë të kësaj strategjie kërkohet një politikë edukative intenzive në mënyrë që të rinjtë të mos përdorin droga dhe të zgjedhin një mënyrë jetese të shëndetshme. Në këtë drejtim duhet të zhvillohen programe të përshtatshme përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të bashkëpunohet edhe me shoqatat rinore, këshillat e prindërve dhe organizatat tjera në nivel kombëtar dhe lokal.

Përfshirja e përmbajtjeve nga fusha e dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i drogave në programet edukative për arsimin fillor dhe të mesëm po ashtu po realizohet në mënyrë josistematike duke i mbuluar disa nga këto përmbajtje në orën e kujdestarisë së klasës ose në kuadër të lëndës për aftësitë për jetën. Pjesa më e madhe e përmbajtjes që ekziston është stigmatizuese, diskriminuese dhe inkurajon paragjykimet.

Ligji i ri për arsimin fillor, i cili fokusohet në përfshirjen sociale, si dhe miratimin e pritur të ligjit të ri për arsimin e mesëm, paraqet një bazë të shkëlqyer për transpozimin dhe përfshirjen e përmbajtjeve dhe metodave të edukimit të përshtatshme për moshën e fëmijëve. Strategjia gjithëpërfshirëse për arsimin 2018-2025 nuk parashikon masa konkrete në këtë drejtim, përderisa në Strategjinë nacionale për të rinjtë në fushën e Shëndetësisë, synimi 1: Për të reduktuar sjelljen e rrezikshme (në lidhje me SRH, përdorimin e duhanit, alkoolin dhe PAH) dhe dhunën tek të rinjtë në Maqedoni nga mosha 15 deri në 25 vjeç deri në vitin 2025, janë paraparë masa për edukimin e të rinjve me qëllim të zvogëlimit të pasojave të dëmshme. Përmbajtjet nga kjo fushë janë të përfshira në fakultetet e mjekësisë, por ato nuk janë të mjaftueshme. Gjithashtu, këto përmbajtje duhet të përfshihen në Fakultetin Pedagogjik dhe në fakultetet e tjera të mësimdhënies.

Trajtimi i varësisë nga drogat Sipas vlerësimit të bërë në vitin 2010 nga ana e Institutit për shëndetin publik për numrin e personave që injektojnë droga (PID) në Republikën e Maqedonisë, llogaritet se numri është 10.200 persona që injektojnë drogë në shtet, nga të cilat 2705 janë në Shkup. Prevalenca e hepatitit C në këtë pjesë të popullsisë është shumë e lartë dhe është 70,1%[4]. Që atëherë, numri i PID vjen duke u zvogëluar. Sipas vlerësimit të bërë në vitin 2017, numri i personave që injektojnë drogë ka rënë ndjeshëm në 6756, ndërsa prevalenca e hepatitit C në popullatën e vlerësuar është 72,9%[5]. Sipas pikës për kontakt kombëtar, numri i përdoruesve problematikë të drogës, kryesisht përdorues që injektojnë opiate, në vend është rreth 8000, që korrespondon me një shkallë prej 1.5 për 1.000 banorë të moshës 15 deri në 64 vjeç.[6]

Shërbimet për trajtimin e varësisë nga droga janë kryesisht të dizajnuara për trajtimin e varësisë nga opiatet në kushte jashtë spitalore ndërsa fillimi i trajtimit me metadon daton nga viti 1979/80 , në kuadër të Spitalit Psikiatrik – Shkup. Trajtimi i të personave të varur nga droga ofrohet brenda rrjetit nacional në objektet shëndetësore. Trajtimi kryhet në spitalet psikiatrike në Shkup, Demir Hisar dhe Negorci, Klinika universitare për toksikologji dhe mjekësi urgjente në Shkup dhe shërbimet për parandalimin dhe trajtimin e të varshmërive nga drogat që funksionojnë në

4 Report from the bio behavioural survey and assessment of population size of injecting drug users in Macedonia, 2010. Skopje, Mikik V. et al., Institute of Public Heath of the Republic of Macedonia.

5 Raport nga hulumtimi biheviorist dhe vlerësimi i numrit të personave që injektojnë drogë në Republikën e Maqedonisë, Mikiq V. dhe të tjerë, Instituti i Shëndetit Publik, 2017.

6 EMCDDA. Country Overview: The former Yugoslav Republic of Macedonia, 2013. http://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overviews/mk, accessed 30 October 2015.

kuadër të spitaleve në Tetovë, Kumanovë, Strumicë, Shtip, Gjevgjeli, Ohër, Manastir, Veles, Kavadar, SPQ "Tetë Shtatori" – Shkup, INK Idrizovë – Shkup dhe INK – Manastir. Sistemi i trajtimit përfshin trajtimin ambulantor, ditor-spitalor dhe spitalor ndërsa zbatohet detoksifikimi ose shumë më tepër trajtimi me opioid agonist (OAT). Shumica e PPD që trajtohen janë në trajtim ditor spitalor, ku u ofrohet trajtim me OAT, intervenime psikosociale, këshillim individual ose grupor dhe terapi sociale dhe psikoterapi.

Në kryeqytetin e Shkupit që nga viti 2008 ekzistojnë katër ordinanca private psikiatrike që trajtojnë PPD me detoksifikim ose mirëmbajtje me OAT, si dhe me antagonistë. Klinika e Toksikologjisë dhe mjekësisë urgjente filloi me trajtimin, kryesisht mirëmbajtje me buprenorfinë, në vitin 2009. Trajtimi me metadon është i disponueshëm në të dy burgjet në Shkup dhe Manastir, ndërsa në burgjet e tjera përmes shërbimeve në qytet ku ndodhet burgu, përjashtim nga kjo bën burgu në Kumanovë dhe burgu në Prlep. Trajtimi afatgjatë për mbajtjen e abstinencës nga droga, rehabilitimi dhe riintegrimi social kryhet në komunën terapeutike "Pokrov" në Strumicë. Personat me diagnozë të dyfishtë, të cilët kanë nevojë për trajtim spitalor, shtrohen në repartin e meshkujve dhe femrave për të sëmurë violent në Spitalin psikiatrik – Shkup ose në repartet psikiatrike në spitalet speciale, të përgjithshme dhe klinike në qytetet tjera të vendit.

Përfshirja e përdoruesve problematikë të drogës në programet e trajtimit është rreth 18,5%, nëse merret parasysh se në vend trajtohen rreth 1600 pacientë[7] me metadon në institucionet publike, private dhe burgje dhe rreth 260 pacientë me buprenorfin. Ilaçi buprenorfin është futur që nga viti 2009, ndërsa që nga viti 2015, ilaçi është i disponueshëm edhe në Qendrën nacionale për parandalimin dhe trajtimin të drogave (QNPTD), e cila trajton shumicën e pacientëve të diagnostikuar me Sindromën e varësisë nga opiatet. Nga viti 2020, ilaçi është i disponueshëm në të gjitha qytetet e vendit. Në burgje, buprenorfina është më vështirë për dispozicion dhe qasje. Gjithashtu, në burgje nuk ka personel të punësuar mjekësor, por mjekët vijnë nga qendrat shëndetësore, që si zgjidhje duhet të ndryshon më tej . Kohët e fundit, departamenti i toksikologjicч pranë Klinikës universitare e ka lëshuar buprenorfinën vetëm për një numër të vogël të të mbrojturve nga INK "Idrizovë" dhe Burgu i Shkupit, të cilët para se të hynin në burg janë trajtuar në klinikë ose një numër jashtëzakonisht i vogël njerëzish nga burgu (vetëm me përpjekje personale nga punonjësit ose familjet). Trajtimi i hepatitit C nuk është i disponueshëm për personat e privuar nga liria.

Mjetet që ndahen për Programin për trajtimin e sëmundjeve të varësisë në kuadër të MSh për periudhën 2017-2021 janë paraqitur në tabelën nr. 6, ndërsa shfrytëzimi i fondeve është 100% që nga viti 2020.

Viti	Buxheti i Programit për trajtim të varësive në Ministrinë e Shëndetësisë
2017	72.000.000 МКД
2018	79.000.000 МКД
2019	79.000.000 МКД
2020 (ribalanc)	80.500.000 МКД
2021	84.500.000 МКД

Tabela nr. 6 (burimi www.zdravstvo.gov.mk)

Falë programeve të trajtimit që fillimisht përdorën vetëm metadonin dhe më vonë programet ZDdhe përdorimin e buprenorfinës, vendi nuk ka pasur asnjë person të vetëm të sëmurë që ka përdorur drogë për shumë vite dhe ende ka një prevalencë të ulët të HIV/AIDS[8] falë të gjitha këtyre programeve, si dhe qasja deri tek në RTSH. Në dhjetë vitet e fundit në Maqedoni janë regjistruar vetëm dy raste të reja me HIV, të infektuar nga injektimi i drogave.

7 Të dhëna nga Ministria e shëndetësisë, statusi dhjetor 2020.

8 Report on the bio behavioural study and population size estimates of people who inject drugs in Skopje, Republic of Macedonia, 2017; http://iph.mk/wp-content/uploads/2019/03/RDS-LID-2018.pdf.

Mirëmbajtja me metadon redukton përdorimin e opiateve të paligjshme, sjelljen e rrezikshme për HIV-in dhe krimin.[9] Programet me OAT gjithashtu zvogëlojnë rrezikun e mbidozimit dhe zvogëlojnë vdekshmërinë nga mbidoza, vdekshmërinë nga SIDA dhe përmirësojnë cilësinë e jetës.[10] Njerëzit që përdorin drogë (me injektim, por edhe ata që nuk injektojnë) janë në rrezik më të lartë të infektimit me HIV për shkak të sjelljeve të rrezikshme nga seksi i pasigurt, kështu që trajtimi i çrregullimeve të shkaktuara nga përdorimi i drogës parandalon rrezikun e HIV/AIDS-it edhe tek njerëzit që nuk e injektojnë drogën.[11]

Programet me OAT (metadon dhe buprenorfinë) kursejnë para në sistemin e drejtësisë, duke e zvogëluar krimin dytësor të shkaktuar nga përdorimi i drogave të paligjshme, reduktojnë popullsinë në burgje, përmirësojnë shëndetin individual dhe publik, duke kursyer kështu para në sistemin shëndetësor dhe ofrojnë një bashkësi më të qetë dhe më të sigurt, respektivisht një cilësi më të mirë jetese në nivel individual dhe shoqëror. Problemi kryesor i identifikuar në lidhje me programet e trajtimit të drogës është mospërshtatja e tyre me nevojat e ndryshueshme të PÇPD dhe ndryshimet në këtë kontekst. Lloje të ndryshme drogash po shfaqen në treg, grupe të ndryshme të popullsisë me nevoja specifike bëhen PÇPD ndërsa programet lokale të trajtimit nuk pasqyrojnë specifika të tilla. Gjithashtu, duhet të përmirësohet cilësia e përgjithshme e programeve duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare të cilësisë së programeve që rregullojnë protokollet e trajtimit, llojet e barnave të përdorura, pranimin e terapisë, rehabilitimin, etj.

Në kuadër të programeve aktuale nuk ka ndjeshmëri në modelet e trajtimit në lidhje me përkatësinë gjinore të LÇPD dhe as në lidhje me moshën. Të dhënat tregojnë se kufiri më i ulët i moshës për PÇPD është ulur, ndërsa nga ana tjetër nuk ekzistojnë qasje që do të merrnin parasysh karakteristikat e fëmijëve që përdorin drogë ose kanë çrregullime nga përdorimi i drogave. Trajtimi i fëmijëve është ende një sfidë serioze për vendin, nuk ka programe specifike për të rinjtë në institucionet shëndetësore. Gjithashtu, po hasen gjithnjë e më shumë të moshuar që po përdorin droga. Grupi po plaket, por po shfaqen edhe përdorues të rinj të opiateve.

BNë një situatë pandemie me Kovid-19, programet e trajtimit u përpoqën të maksimizonin nevojat dhe të ofronjnë trajtim të përballueshëm për individët. Megjithatë, ekziston nevoja për një mbështetje të shtuar jo-fizike për PÇPD, si hapja e linjave të këshillimit dhe trajtimit. Për më tepër, mbështetja ekzistuese psikosociale e ofruar për PÇPD nuk merr parasysh nevojat në situata të caktuara krize, për shembull, pandemitë, situatat e të pastrehëve, situatat e krizave familjare.

Vështirësitë administrative janë të shumta si për PÇPD ashtu edhe për personelin profesional që punon në qendrat e varësisë dhe në institucionet mjekësore që tregojnë mbështetje për PÇPD. Trajtimi paralel me substitut në dy institucione, shpërndarja e centralizuar e barit nalokson, mungesa e komunikimit efektiv me institucionet e tjera shëndetësore në rast të ekzistimit të sëmundjeve shoqëruese somatike dhe psikiatrike, si dhe problemet me sigurimin e metadonit për një të shtruar që nuk është në trajtim, janë vetëm disa nga problemet që dalin nga barrierat dhe pengesat e ndryshme administrative që do të duhet të zgjidhen në periudhën e ardhshme strategjike. Gjithashtu nevojitet ngritja profesionale e stafit profesional në fushën e trajtimit të varësisë, si dhe edukimi i vazhdueshëm për t'iu përgjigjur nevojave të përdoruesve përfundimtarë dhe tendencave të reja të trajtimit.

Prodhimi dhe tregtimi i kanabisit për qëllime mjekësore: Sipas propozim ligjit për drogat dhe substancat narkotike, lejohet kultivimi i kanabisit, si dhe prodhimi i farës dhe materialit fidanor të kanabisit për qëllime mjekësore dhe/ose shkencore. Kanabisi për qëllime mjekësore është çdo pjesë e freskët ose e tharë mbi tokë e bimës, duke përfshirë farat. Kultivimi i kanabisit lejohet vetëm për personat juridikë që kanë leje për kultivimin e kanabisit të lëshuar nga Agjencia për kontrollin e kultivimit dhe prodhimit të kanabisit dhe produkteve të kanabisit për qëllime mjekësore dhe shkencore, me pëlqimin paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Masa e thatë në formë

9 Marsch L. A. The efficacy of methadone maintenance interventions in reducing illicit opiate use, HIV risk behavior and criminality: a meta-analysis. Addiction. 1998 Apr; 93(4): 515-32. doi: 10.1046/j.1360-0443.1998.9345157.x. PMID: 9684390.

10 Marta Torrensa, Francina Fonsecaa, Claudio Castilloa & Antonia Domingo-Salvanyb. Methadone maintenance treatment in Spain: the success of a harm reduction approach Bulletin of the World Health Organization 2013; 91: 136-141. doi: 10.2471 / BLT.12.111054.

11 https://www.drugabuse.gov/publications/research-reports/hivaids/letter-director

luleje e përfituar nga bima e tharë e kanabisit është sugjeruar të eksportohet nga kultivuesit e kanabisit. Personat juridikë janë të obliguar që mjetet nga fitimi i tyre vjetor t'i paguajnë në llogarinë përkatëse, mjete të cilat janë të hyra në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për shfrytëzimin e këtyre mjeteve, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut sjell një program të veçantë.

Çdo qytetar ka të drejtë në mbrojtje shëndetësore si dhe të drejtën për të përmirësuar shëndetin e tij. Për këto arsye, zgjedhja e përdorimit të preparateve dhe/ose drogave të kanabisit është një mundësi që i jepet çdo pacienti që nuk duhet t'i merret nga ana e mjekut të tij. E drejta për informacion përkatës mjekësor, si dhe e drejta për të zgjedhur nëse pacienti do të trajtohet vetëm me barna konvencionale (mjekësi, të bazuara në fakte) ose do të pranojë edhe trajtim me kanabis, nëse përdorimi i kanabisit është treguar për sëmundjen specifike është një e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nisur nga përfitimet ekonomike të kultivimit të kanabisit, siq është fluksi i pritshëm i eksporteve të kanabisit, vende të reja të punës për njerëzit që do të punonin në objektet e prodhimit, duket e justifikuar që një pjesë e përqindjes së të ardhurave të paguara nga personat juridikë të caktohet për zbatimin e prioriteteve dhe aktiviteteve në Strategjinë nacionale. Në atë drejtim nevojitet një qasje dhe avokim i përbashkët që një pjesë e mjeteve të përdoren për zbatimin e strategjisë.

Ulja e dëmeve nga përdorimi i drogave: Sipas Qendrës Evropiane për monitorim të drogave dhe varësitë nga drogat, reduktimi i dëmeve përkufizohet si një grup aktivitetesh, programesh dhe politikash që synojnë reduktimin e pasojave shëndetësore, sociale dhe ekonomike të përdorimit të drogave në nivel individual, lokal dhe kombëtar.

Në vitin 1996, në Republikën e Maqedonisë u hap programi i parë për zvogëlimin e dëmit (me shkëmbim të pajisjeve për injeksion) dhe parandalimin e HIV-it tek PPD. Me mbështetjen e Fondit Global, nga viti 2004 u hapën gjithsej 17 programe të tilla në 14 qytete. Falë këtyre programeve dhe programeve të mirëmbajtjes me substitut, në dhjetë vitet e fundit në Maqedoni janë regjistruar vetëm dy raste të reja me HIV, të infektuar nga injektimi i drogave.

ДAktualisht janë aktive 15 programe për reduktimin e dëmeve nga drogat (PRD) në 13 qytete: Shkup, Kumanovë, Shtip, Strumicë, Gjevgjeli, Kavadar, Veles, Prlep, Manastir, Ohër, Strugë, Kërçovë dhe Gostivar. Në këto programe, në terren dhe në qendra, PPD marrin një gamë të gjerë shërbimesh që ofrojnë qasje të lehtë në kujdesin shëndetësor dhe social, ndihmë juridike, si dhe përfshirje në jetën sociale të PPD dhe familjarëve të tyre. Nuk ka PRD në burgje, gjë që kërkon konsultim të mëtejshëm me Administratën për zbatim të sanksioneve, në lidhje me aspektet e kujdesit shëndetësor dhe përdorimit të drogës.

Studimet ekzistuese ndërkombëtare tregojnë se shkalla e HIV-it në qytetet ku ekzistojnë programe të tilla ulet për 18.6% në vit, ndërsa në të kundërtën rritet për 8.1% në vit.[12] Përveç parandalimit të HIV-it, këto programe çojnë në: përmirësimin ose lehtësimin e qasjes në kujdesin shëndetësor dhe social, si dhe trajtimin e varësive, parandalimin e infeksioneve të tjera të transmetueshme me anë të gjakut dhe seksuale, reduktimin e infeksioneve bakteriale, reduktimin e sjelljeve të rrezikshme[13], [14] etj.

Ka prova të rëndësishme që programet e reduktimit të dëmit (shkëmbimi i pajisjeve sterile për injektim) dhe programet e mirëmbajtjes me substitut janë më efektive nëse ato ekzistojnë brenda një bashkësie. Më shumë studime tregojnë se kombinimi i këtyre dy programeve rrit efektivitetin në uljen e incidencës së HIV-it dhe hepatitit C, më saktësisht se efektiviteti i tyre është dukshëm më i ulët kur ekziston vetëm njëri nga këto programe.[15]

Për një efiaksitet edhe më të madh të këtyre programeve është e nevojshme të mundësohet hapja e dhomave për injektim të cilat do të reduktojnë në masë të madhe vdekjet nga mbidoza.

12 Health Outcome International, Return on investment in needle and syringe programs in Australia: report, 2002.
13 WHO, Effectivness of sterile needle and syringe programming in reducing HIV/AIDS among injecting drug users, WHO 2004.
14 EMCDDA, Harm reduction, evidence impacts and challenges. EMCDDA 2010.
15 Van Den Berg et al. Full participationin Harm reduction programmes is associated with decreased risk for HIV and hepatitis c virus: evidence from the Amsterdam cohort studies among drug users. Addiction 102. P 1454-1462, 2007.

Në tabelën nr. 7 janë dhënë tregues për mbulimin e PID përmes PRD në periudhën 2018-2019.

PID të përfshirë gjithsej përmes PRD	2018	2019
PID të rinj të përfshirë përmes PRD	4.450	4.167
Gjithsej gjilpëra të ndara të ndara për PID	555	443
Gjithsej shiringa të ndara për PID	676.922	728.952
Gjithsej prezervativë të ndarë për PID	417.010	442.678
Gjithsej materiale IEK të ndara për PID	93.008	70.451
Gjithsej lubrifikantë të ndarë për PID	43.391	36.049
Gjithsej shërbime mjekësore dhe informacione të ofruara	12.539	24.295
Totali i shërbimeve sociale të ofruara	42.981	42.865
Totali i shërbimeve ligjore të ofruara	18.063	17.497
Totali i shërbimeve psikologjike të ofruara	456	455
Gjithsej të dorëzuara teste të HIV-it	988	1.014
Gjithsej numri i shërbimeve të ofruara në qendrën ditore	/	255
Gjithsej shërbime të tjera të ndryshme të ofruara në terren	/	37.313
Вкупно разни други услуги дадени на терен	42.528	5.608

Tabela nr. 7

Duke filluar nga viti 2018, PRD nga përdorimi i drogave financohen nga Ministria e shëndetësisë përmes programit vjetor për mbrojtjen e popullatës nga HIV/AIDS. Megjithatë, këto mjete në vlerë prej 21.670.000 denarë të pranuara nga organizatat e shoqërisë civile nuk mjaftojnë as për pakon minimale të shërbimeve që ata ua ofrojnë PPD dhe familjeve të tyre. Me ato mjete financiare nuk ekziston mundësia për shërbime nga psikologu, nga këshilltari ligjor, për ngjarje edukative, shtypje broshurash, blerje materialesh mjekësore etj. Kjo ndikon në mbulimin e përgjithshëm të klientëve, si dhe në disponueshmërinë e shërbimeve. Gjithashtu, për shkak të mungesës së financave, këto programe nuk arrijnë t'i përshtatin aktivitetet programore sipas nevojave, gjegjësisht përballen me mungesë fondesh për punësimin e personelit dhe kapaciteteve të tjera që e bëjnë të pamundur përmirësimin e përgjigjes së programit ndaj përdoruesve. Kjo vë në pikëpyetje qëndrueshmërinë financiare të programeve.

Qasje e vështirësuar e PPD, stigma dhe diskriminim: Stigma dhe diskriminimi ndaj PPD janë të pranishme në të gjitha nivelet e shoqërisë. Studimet tregojnë se njerëzit që përdorin substanca janë më të stigmatizuar se disa grupe të tjera dhe përdorimi i drogës konsiderohet shumë më tepër si një gabim moral sesa një gjendje shëndetësore.[16] Përveç ekspozimit ndaj stigmës dhe diskriminimit nga mjedisi ku jetojnë, këta persona janë të ekspozuar ndaj stigmës dhe diskriminimit në institucionet që duhet t'u ndihmojnë, si në procesin e trajtimit të varësisë, ashtu edhe në arritjen e qasjes deri tek drejtësia. Nga kjo lind nevoja për znatim të edukimit dhe sensibilizimit sidomos të punonjësve në institucione që punojnë në pozicione frontale për sa i përket pranimit, ndihmës dhe trajtimit të mëtejshëm të PPD. Stigma dhe diskriminimi është i pranishëm edhe ndaj familjeve të PPD dhe njerëzve në afërsi të tyre. Pjesa më e madhe e punonjësve në QNPTVD janë të sensibilizuar dhe nuk përballen me probleme të stigmës apo diskriminimit, gjë që nuk është rasti edhe jashtë institucionit, veçanërisht në sektorin e shëndetësisë.[17] Në Republikën

16 https://www.recoveryanswers.org/research-post/substance-use-is-more-stigmatized-than-both-smoking-obesity/

17 Zyra e OBSH-së, Shkup. Raport i anketës së opinionit publik për të drejtat dhe stigmat lidhur me grupet e rrezikut dhe HIV/AIDS në Shkup, Prlep dhe Veles. Gusht 2016, Shkup.

e Maqedonisë së Veriut është miratuar Ligji për mbrojtje nga diskriminimi, i cili është i një rëndësie të veçantë për realizimin e të drejtave të personave të varur dhe të cilët vazhdimisht përballen me diskriminim.

Shërbime sociale, rehabilitimi, risocializimi dhe riintegrimi i PPD: Në bazë të Ligjit për mbrojtjen sociale, Ministria për punës dhe politikës sociale (MPPS) përcakton termat "ofrues të licencuar të shërbimeve sociale" të cilët janë ofrues të shërbimeve që plotësojnë normat dhe standardet për ofrimin e shërbimeve dhe kanë marrë licencë për të kryer veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale si dhe ofruesit e autorizuar të shërbimeve të cilët janë ofrues të licencuar të shërbimeve të cilët kanë lidhur marrëveshje administrative me MPPS-në, përkatësisht komunat, Qytetin e Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe ofrojnë shërbime me vendim të Qendrës për punë sociale. Edhe krahas kësaj mundësie ligjore, është evidente se sistemi i ofrimit të shërbimeve sociale në nivel lokal ende nuk është zhvilluar dhe ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të mundshëm të shërbimeve sociale (siq janë OShC-të) për tu aftësuar dhe licencuar që të ofrojnë shërbime të tilla. Pushteti lokal është gjithashtu i painteresuar për të zhvilluar shërbimet sociale në nivel lokal.

Në Shkup funksionon qendra ditore për risocializim e menaxhuar nga shoqata HOPS me mbështetjen e Qytetit të Shkupit dhe donatorëve të tjerë. Sa i përket risocializimit dhe rehabilitimit të personave, institucioni social "Pokrov" në Strumicë ofron program psikosocial për trajtimin, risocializimin dhe riintegrimin e personave që kanë probleme me varësinë nga droga, alkooli dhe bastet si dhe anëtarëve të familjes së tyre, me kompensim financiar nga ana e përfituesve. MPPS ofron shërbim akomodimi për 30 persona me probleme të varësisë dhe persona të tjerë të margjinalizuar që kanë nevojë për trajtim dhe rehabilitim, terapi pune - okupacionale, mbështetje për përvetësimin e aftësive për punë, riintegrim dhe jetesë të pavarur. Në fazën e riintegrimit mundësohet punësimi i klientëve tashmë të rikuperuar në institucionin social, përmes ekonomisë sociale që e zhvillon bashkësia.

PPD dhe ish PPD përballen me pengesa në kërkimin e mundësive për punësim. Ata nuk posedojnë aftësitë që do t'ju mundësojnë hyrjen në tregun e punës. Përmes masave aktive të punësimit të MPPS-së dhe APRMV, ofrohen mundësi për punësimin e personave nga bashskësitë e margjinalizuara përmes stimulimeve dhe beneficioneve, si për punëdhënësit ashtu edhe për punëkërkuesit të cilët gjithashtu kanë mundësi të ndjekin edhe trajnime kualifikuese.

Fusha: Oferta e drogave

Tregtia e paligjshme me drogë dhe karakteristikat e saj: Republika e Maqedonisë së Veriut shfaqet si vend tranziti dhe pjesë e rrugës ballkanike për transportin e drogës në Evropën Perëndimore. Shërbimet policore në Maqedoni janë përgjegjëse për zbulimin, vërtetimin dhe sqarimin e krimeve të lidhura me drogën, përfshirë edhe narko-krimin në nivel lokal dhe kombëtar, me ndihmën e bashkëpunimit me vende të tjera apo organizata ndërkombëtare edhe në nivel global. Njëkohësisht, punonjësit e policisë janë përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, nga këtu del që kanë kompetencë të veprojnë në rastet e cenimit të rendit dhe qetësisë publike nga PPD të cilët përdorin drogë në vende publike dhe për këtë lloj shkeljeje janë kompetent që të shqiptojnë sanksione kundërvajtëse dhe konfiskimin e drogës së gjetur. Prandaj, kompetencat e policisë në vendin tonë burojnë nga Ligji për Punë të Brendshme, Ligji për Policinë dhe Ligji për Kundërvajtje kundër Rendit dhe Paqes Publike.[18]

CSipas Vlerësimit për kërcënime nga krimi i organizuar serioz, i përgatitur nga Ministria për punë të brendshme, "tregtia e palejuar me droga (TP) është njëra nga aktivitetet më profitabile në të cilën janë të përfshirë numri më i madh nga grupet e organizuara kriminele (GOK). Në tregtinë e paligjshme me heroinë janë të përfshira GOK që organizojnë transporte ndërkombëtare të destinuara për shtetet e Evropës perëndimore, nga të cilat sasi të vogla përfundojnë edhe në narko-tregun vendor. Prejardhja e heroinës është nga Turqia, e cila hyn në Maqedoni përmes Greqisë dhe Bullgarisë, pjesërisht ruhet për transport të mëtejshëm ose tranzit në Kosovë dhe Serbi deri në destinacionin e fundit. Kokaina është e pranishme në sasi të vogla në tregun e drogës në Maqedoni, për shkak të çmimit të lartë dhe kërkesës së ulët për këtë lloj droge. Në Maqedoni, kokaina vjen nga portet e rajonit, të cilat janë pikat e tranzitit të rrugëve tashmë të krijuara për transport të kokainës. Trafikimi i paligjshëm i kokainës është zakonisht një veprimtari dytësore kriminale e GOK, e cila përdor të njëjtat mënyra, rrugë dhe burime të krijuara tashmë për llojet e tjera të drogës. Në periudhën e kaluar tregtimi i paligjshëm i marihuanës shënon zgjerim, deri në uljen e prodhimit në Republikën e Shqipërisë, si furnizuesi kryesor në treg. Pas uljes së prodhimit të marihuanës në Shqipëri, oferta zvogëlohet, gjë që rezultoi me rritjen e çmimit në treg. Sasitë më të mëdha të marihuanës të importuara nga Shqipëria janë të destinuara për transport drejt vendeve të Bashkimit Europian, ndërsa një pjesë përfundon në tregun vendas. Me uljen e ofertës së marihuanës të prodhuar në Shqipëri, u intensifikua prodhimi i marihuanës në Maqedoni. Drogat sintetike në tregun vendas vijnë kryesisht nga vendet fqinje të rajonit dhe importohen në sasi më të vogla. Ka një trend në rritje të popullaritetit të drogave sintetike në tregun e drogës, veçanërisht ekstazi, për shkak të çmimit të ulët në krahasim me çmimet e drogave të tjera që janë në rritje. Tregtia e paligjshme e drogave sintetike është një veprimtari kriminale dytësore e GOK, të cilat tashmë kanë krijuar metoda të tregtisë me drogë. "Përveç ekstazi-së si më prezente, në tregun e drogës po shfaqen lloje të reja të drogave sintetike si dhe ka tentativa për prodhim vendas".[19]

Zhvillimi i pamjaftueshëm informatik-teknologjik dhe i pajisjeve të shërbimeve të luftës kundër tregtisë së drogësa: Në raportin për vlerësimin e bërë nga MPB thuhet se "nga fillimi i vitit 2014 në MPB ka filluar zbatimi i procesit të kundërzbulimit kriminal, përkatësisht puna policore e udhëhequr nga inteligjenca, që nënkupton futjen e një sërë procedurash standarde operative me qëllim standardizimin e punës së policisë me atë të vendeve anëtare të BE-së. Futja e modelit nacional të zbulimit imponoi detyrimisht një riorganizim të Byrosë për siguri publike, i cili ndryshoi ndjeshëm funksionin e shërbimeve analitike në Byro dhe i shtoi funksionit analitik ekzistues, të orientuar kryesisht në statistika, funksionin e inteligjencës, i cili kryhet duke krijuar vende të veçanta pune - inspektorë për kundërzbulim të cilët janë përgjegjës për mbledhjen e duhur dhe të synuar, vlerësimin dhe ndarjen e informatave të inteligjencës të mbledhura nga të gjithë punëtorët e policisë në kuadër të Byrosë. Megjithatë, caktimi i këtij funksioni të rëndësishëm nuk u mbështet nga zhvillimi adekuat informatik dhe pajisjet e duhura teknike, kështu që për momentin

18 Стручна статија ,Навременото откривање на трговијата со дроги од страна на полициските служби –императив за превенирање на зависноста од дроги", д-р Софка Хаџиевска, достапно на: file:///C:/Users/bmspa/Documents/HOPS%20strategija%20za%20drogi/Docs/Sofka%20Hadzievska.pdf.

19 Vlerësim i kërcënimeve nga krimet e rënda të organizuara, Ministria për punë të brendshme, 2016, në dispozicion në: file:///C:/Users/bmspa/Documents/HOPS%20strategija%20za%20drogi/Docs/SOCTA_v_11_03_2016_facing.pdf

shërbimet analitike nuk i përmbushin as nga larg standardet e kërkuara nga një njësi bashkëkohore e kundërzbulimit të krimit, megjithëse ekziston një bazë e të dhënave kombëtare të kundërzbulimit që është një sistem i integruar i informatave që mundëson përpunimin dhe përdorimin e të dhënave midis organeve kompetente shtetërore si dhe shkëmbimin me subjekte të huaja, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e krimeve në pajtim me ligjin".[20]

Politika e papërshtatshme penale për kryerësit e krimeve: Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, krimet e lidhura me drogën janë të inkriminuara në Kapitullin 21 të Kodit penal, i cili aktualisht është në fazë të ndryshimit. Prodhimi dhe shpërndarja e paautorizuar e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve (neni 215 i K.penal) dhe Mundësimi i përdorimit të drogave narkotike (neni 216 i K.penal) janë vepra penale për të cilat parashikohet burgim për kryerësit e veprave. Gjithashtu, Kodi penal, nenet 61, 62 dhe 65, mbulon masat e sigurisë dhe sanksionet që vlejnë edhe për PPD, të cilat duhen përshtatur.

Zbatimi jo i plotë i legjislacionit nga autoritetet gjyqësore duke mos caktuar masën e konfiskimit të zgjeruar të pronës, kur ka një disproporcion të dukshëm midis gjendjes aktuale të pasurisë dhe të ardhurave të realizuara ligjërisht, për personat e përfshirë në veprimtari kriminale, u mundëson anëtarëve të grupeve kriminale të ripërtrijnë lehtësisht lidhjet në qarqet kriminale dhe të vazhdojnë me aktivitetet kriminale.[21] Aktualisht, pjesa më e madhe e përndjekjes drejtohet ndaj PPD, me çka kriminalizohet përdorimi i drogës, megjithëse KP nuk e njeh përdorimin si krim[22], ndërsa nga ana tjetër praktika gjyqësore tregon se për të pandehurit të cilët janë pjesë e grupeve të krimit të organizuar ndonjëherë shqiptohen dënime shumë të ulëta, madje edhe me kusht. Masa e dënimit nuk korrespondon me krimin e kryer. Kështu, shumë më e lartë është përqindja e të dënuarve për kundërvajtje me drogë që janë gra.

Ligji për probacion ka filluar të zbatohet në vitin 2017. Përgatiten plane për të gjithë personat, përfshirë PPD, të cilat më pas u përcillen institucioneve dhe organizatave të tjera. Është e nevojshme të vazhdohet me vendosjen e masave alternative dhe lirimin me kusht për të forcuar këtë praktikë.

Departamenti për kundërzbulim dhe analizë kriminale në MPB ka përgatitur një analizë përmbledhëse të krimit të përgjithshëm në Maqedoni sipas fushave dhe sektorëve në periudhën nga 2010 deri në 2016. Në analizë janë përpunuar gjithashtu edhe të dhëna në lidhje me trafikun e paligjshëm të drogës. Në tabelën nr. 8 dhe tabelën nr. 9 janë të radhitura situatat në fushën e tregtisë së paligjshme me drogë në Maqedoni

.

20 Njëlloj si 19.
21 Njëlloj si 19.
22 Ndëshkimi i kundërvajtësve të drogës, politika legjislative dhe praktika gjyqësore, Boshkova N, Tupançevski N, 2015.

Situatat në fushën e tregtisë së paligjshme me drogë[23]										
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Vepra penale të regjistruara gjithsej	578	596	604	555	717	611	608	552	789	896
Kryerës të veprave të regjistruar gjithsej	713	719	736	668	872	718	708	629	905	1004
Neni 215 - Prodhimi i paautoriz. dhe lëshim në treg të drogave nark. substanc. psikotr. dhe prekursorëve	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Vepra penale të regjistruara	494	481	468	421	577	515	488	464	673	763
Kryerës të veprave të regjistruar	616	588	586	514	714	615	572	532	782	863
Neni 216 - Mundësimi i përdorimit të drogave narkotike	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Vepra penale të regjistruara	84	115	136	134	140	96	120	88	116	133
Kryerës të veprave të regjistruar	97	131	150	154	158	103	136	97	123	141

Tabela nr. 8

Sipas të dhënave të dhëna, mund të konstatohet se shumica e krimeve të kryera në vazhdimësi nga viti 2010 e në vazhdim janë për prodhim dhe shpërndarje të paautorizuar të narkotikëve, substancave dhe prekursorëve. Nga viti 2016 e këtej ka pasur një rritje të krimeve në këtë sferë nga 488 në vitin 2016 në 763 në 2019 ndërsa tek kryerësit e veprave nga 572 në vitin 2016 në 863 në 2019-ën. Veprat penale për mundësimin e përdorimit të drogave narkotike shënojnë një tendencë të parregullt, ku në periudhën 2010-2014 ka një tendencë të rritjes së vazhdueshme, në vitin 2015 ka një rënie drastike ndërsa në vitin 2019 ka një rritje të lehtë krahasuar me numrin e vitit 2016.

Konfiskimet totale të drogës sipas llojit dhe sasisë - sipas neneve 215 dhe 216										
Konfiskime	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Marihuana në kilogramë	459,7	286,4	784,6	477	632	226	623,7	510,18	1.532,43	977,20
Heroinë në kilogramë	37,1	23,7	55,3	11,7	20,2	5,36	0,8	1,4	1,97	0,73
Kokaina	2 kg	1,5 kg	173 g	15,8 g	318 g	0,07 kg	717 g	263,84 g	586,69 g	852,3 g
Trung të kanabisit	4.199	1.247	2.755	1.421	1.187	2.362	2.414	389	819	131
Tableta ekstazi	459	3.628	206	142	1,217	490	522	1.187	472	409,5

Tabela nr. 9

23 Analizë përmbledhëse e krimit të përgjithshëm sipas sektorëve sipas fushave për periudhën 2010-2019 në RMV, burim, faqja e internetit e MPB-së, e qasur më 10.11.2020: https://mvr.gov.mk/analiza/kriminal/55.

Tek marihuana shënohet rritje e sasive të konfiskuara në 2018 dhe 2019, kokaina ka një tendencë të vazhdueshme në rritje të sasive të konfiskuara, ndërsa tek tabletat ekstazi, sasia më e madhe e konfiskuar a qenë në 2017.

Fusha: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i koordinimit dhe komunikimit ndërmjet institucioneve kompetente në përputhje me praktikat dhe standardet e mira

Roli, përbërja dhe funksionaliteti i Komisionit ndërsektorial: Roli i Komisionit ndërsektorial është përcaktuar në Ligjin për kontrollin e drogave dhe substancave dehëse. Në përbërjen e deritanishme të Komisionit janë përfshirë përfaqësues nga disa prej ministrive, por përkundër këtij përfaqësimi dhe përbërjeje, është e nevojshme të përfshihen përfaqësues nga ministritë e tjera që janë të lidhura ngushtë me këtë sferë, por që nuk kanë zyrtarisht anëtarë në Komision. Gjithashtu edhe organizatat e shoqërisë civile marrin pjesë në grupet punuese me ftesë dhe kontribuojnë me informacion dhe njohuri nga puna e tyre.

Propozim ligji për kontroll të drogave dhe substancave dehëse, i cili tashmë është në procedurë parlamentare, përcakton qartë kompetencat e përfaqësuesve të ministrive dhe institucioneve, si dhe përfshirjen e një përfaqësuesi nga organizatat e shoqërisë civile si anëtar i Komisionit dhe vendosja e kompensimit monetar për punën e anëtarëve të Komisionit.

Qasja e koordinuar në krijimin e politikave mbi drogat: Në përputhje me përvojat evropiane, si dhe kërkesat që i imponohen vendit tonë nga procesi i negociatave të anëtarësimit, është e nevojshme të forcohet qasja e koordinuar dhe politikëbërja e centralizuar për drogat në kuadër të Ministrisë së shëndetësisë dhe Komisionit ndërsektoral si organ këshillimor, koordinues dhe profesional.

Rëndësi të veçantë në këtë kontekst ka edhe forcimi i Qendrës për monitorim të drogave dhe ngritja e Sistemit për paralajmërim të hershëm si detyrime kyçe që imponohen për plotësimin e kushteve dhe kritereve për anëtarësim në BE.

Në vitin 2007, Qeveria miratoi një vendim për krijimin e Qendrës për monitorimit të drogave (pika kontakti nacional), ku vendimi përcakton detyrat e kësaj qendre dhe emëron të gjitha institucionet që janë të detyruara të dorëzojnë informata. Sipas Raportit të EMCDDA të janarit 2020[24] me rekomandime për përshtatje me standardet e EMCDDA, rekomandohet fuqizimi i Qendrës për monitorim të drogave dhe varësive nga drogat. Personeli që do të punojë në atë qendër duhet të trajnohet siç duhet për të zbatuar standardet dhe metodat e EMCDDA për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Duke vepruar kështu, raporti i EMCDDA rekomandon në mënyrë specifike krijimin e një rrjeti ekspertësh dhe grupesh pune që janë kyç në sistemin e monitorimit, mbledhjes së të dhënave dhe analizës. Ato grupe, sipas fushave tematike, janë: Përdorimi i drogës në popullatën e përgjithshme dhe në mesin e të rinjve - General Population Survey - GPS (Anketa e Përgjithshme e Popullsisë), drug related deaths-DRD (vdekjet e lidhura me drogën), përdorimi i drogës me rrezik të lartë (High risk drug use-HRDU); sëmundjet infektive të lidhura me përdorimin e drogës (drug related infectious diseases -DRID); dhe treguesi për kërkesë për trajtim (treatment demand indicator-TDI).

Në kuadër të qasjes së koordinuar, përveç në pjesën e politikave, konstatohet edhe nevoja për krijimin e standardeve nacionale për cilësinë e programeve. Krijimi i një regjistri të vetëm të sëmundjeve të varësisë, si dhe regjistrave të tjerë sipas nevojave, do të mundësojë rrjedhjen e mëtejshme të informacionit të përditësuar për situatën me drogat në një vend dhe përdorimin e të dhënave në kryerjen e vlerësimeve të efektivitetit të programeve ekzistuese.

24 North Macedonia, Roadmap to participation in the EMCDDA, January 2020.

Marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare në fushën e drogës: RMV ka obligim të raportojë deri tek institucionet ndërkombëtare për çështjen e drogës si dhe të marrë pjesë në iniciativat dhe veprimet e përbashkëta që janë të zbatuara nga institucionet ndërkombëtare. Këto marrëdhënie duhet të forcohen më tej si dhe të zhvillohet sistemi për raportim të situatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Anëtarësimi në BE dhe hapja e mundshme e negociatave imponon detyrime në menaxhimin e të dhënave, ndaj vendit tonë do t'i duhet të forcojë kapacitetet kombëtare duke krijuar baza të dhënash në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duke raportuar me përdorimin e atyre të dhënave. RMV është anëtare e Grupit Pompidou në Këshillin e Evropës dhe merr pjesë aktive në aktivitetet e grupit në lidhje me parandalimin, trajtimin dhe reduktimin e ofertës.

Kapacitete për punë profesionale, koordinim dhe komunikim të ndërsjellë midis institucioneve kompetente: Në institucionet amë që janë përgjegjëse për zbatimin e politikës për drogë mungon kuadri profesional dhe kompetent që do të punojë me PPD ndërsa personelit ekzistues i mungon edukimi i rregullt plotësues për t'iu përgjigjur nevojave të PPD dhe për të zbatuar programet për punë me PPD me cilësinë e kërkuar në përputhje me standardet që zbatohen ndërkombëtarisht.

Koordinimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet institucioneve për plotësimin e nevojave të PPD, si dhe shkëmbimi i informatave është i vështirë, protokollet e bashkëpunimit dhe rrugët e lëvizjes, veçanërisht në shëndetësi, janë të vjetruara dhe nuk i përfshijnë nevojat ndryshuese dhe kontekstin. Trajtimi nuk përfshin nivelin e shëndetit parësor dhe terciar për punën me personat e varur.

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e politikave të drogës: Një sfidë e rëndësishme në zbatimin e strategjisë së mëparshme ishte mu mungesa e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve nga ana e institucioneve, krahas nevojës për koordinim dhe harmonizim më të madh. Sfida për burime të pamjaftueshme ekziston aktualisht, si për sigurimin e fondeve për punësimin e personelit plotësues, ashtu edhe për prokurimin e pajisjeve të nevojshme, hapjen e programeve të reja të trajtimit dhe NS, relizim të edukimit dhe trajnimit të personelit, motivimin financiar të personelit që punon me PPD, si dhe fonde më të mëdha në programet për reduktim të dëmeve. Në këtë kontekst, strategjia duhet të parashikojë mënyra të reja për sigurimin e fondeve dhe një qasje të koordinuar për këto mundësi financimi. Gjithashtu, sipas propozim ligjit për kontrollin e drogave dehëse dhe substancave psikotrope, një pjesë e mjeteve të planifikuara për t'i paguar në Ministrisë e shëndetësisë në llogari të posaçme nga ana e prodhuesve të kanabisit, do të mund të drejtoheshin mu në forcimin dhe mbështetjen financiare të programeve parandaluese, trajtim dhe reduktim i dëmevenga përdorimi i drogës.

Mungesa e nismave të koordinuara për ndryshimin e praktikës dhe legjislacionit: Është evidentuar nevoja për ndryshim në legjislacionin ekzistues, në radhë të parë në lidhje me nenet 215 dhe 216 të Kodit penal, si dhe në lidhje me dënimin e mbajtjes së drogës për përdorim personal. Në praktikë, prokurorët publikë dhe gjykatat kanë interpretime të ndryshme të këtyre neneve dhe praktikë të pabarabartë gjyqësore. Në këtë kontekst, nevojitet planifikimi qendror i ndryshimeve të tilla për të përshtatur të drejtën me nevojat në këtë kontekst. Mirëpo, përveç kësaj çështjeje, nuk ka qëndrime të harmonizuara të palëve të ndryshme për çështje të tjera juridike që duhet të rregullohen. Përfaqësimi i një numri të organizatave të shoqërisë civile për këto çështje nuk është i mjaftueshëm dhe është e nevojshme që këto çështje të rëndësishme të trajtohen përmes një qasjeje të vetme kombëtare nga institucionet kompetente që janë anëtare të Komisionit ndërsektoral.

2. TEORIA E NDRYSHIMIT

Bazuar në analizën e kontekstit, kapaciteteve dhe ndikimeve të palëve të interesuara, si dhe legjislacionit, strategjive, programeve dhe konventave ndërkombëtare, marrëveshjeve dhe rregulloreve në dispozicion, u përcaktua ndryshimi i pritshëm në tre sfera kryesore në fushën e drogës. Ndryshimet do të maten përmes treguesve të suksesit, të parashikuar për çdo prioritet.

Prioriteti strategjik 1: Ulja e kërkesës për droga

Nëse:

- Përgatitja e standardeve kombëtare për parandalim që do të integrohen në planprogramet e programeve arsimore dhe parandaluese në shëndetësi;
- Të zhvillohen programe cilësore për trajtim nga varshmëritë nga droga që përfshijnë të gjithë PPD sipas gjinisë, moshës dhe llojit të drogës që ata përdorin;
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë dhe cilësisë së PZD;
- Të rritet numri i ofruesve të shërbimeve sociale në nivel lokal në sistemin e risocializimit, rehabilitimit dhe riintegrimit.

Atëherë:

Do të rritet ndërgjegjësimi për efektet e dëmshme të drogës ndërsa për PPD do të sigurohet qasje më e mirë në programet e përshtatura për nevojat e tyre në drejtim të trajtimit, reduktimit të dëmit, qasjes më të lehtë deri tek drejtësia si dhe programeve të risocializimit, riintegrimit dhe rehabilitimit.

Që do të çojë në:

Zvogëlimi i numrit të të rinjve PPD, mbulim më i madh i PÇPD përmes programeve për trajtim të varësive nga droga, PZD, risocializim, rehabilitim dhe riintegrim, ulje e numrit të PÇPD dhe PID dhe me këtë ulje e kërkesës për droga.

Treguesit e suksesit për Prioritetin 1:

P1.1: Përqindja e popullsisë sipas llojit të drogës, moshës dhe gjinisë e cila:
- ka përdorur drogë muajin e fundit,
- ka përdorur drogë gjatë vitit të fundit,
- ka përdorur drogë kordoherë gjatë jetës.

Burim i të dhënave: General Population Survey

P1.2: Shkalla e vdekshmërisë së shkaktuar/e lidhur nga droga; Burim i të dhënave: Enti shtetëror për statistika, Instituti i mjekësisë ligjore

P1.3: Prevalenca dhe incidenca tek PID e sëmundjeve infektive të shkaktuara nga përdorimi i drogës (përfshirë HIV dhe hepatitin viral, sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe tuberkulozin); Burimi i të dhënave: IShP

P1.4: Shkalla e përdorimit të drogave të paligjshme tek fëmijët e moshës 16 vjeç (sipas llojit të drogës, gjinisë dhe periudhës së përdorimit të fundit); Burimi i të dhënave: Studimi ESPAD, IShP

P1.5: Numri i personave që hyjnë në trajtim nga përdorimi i drogës (në vit) dhe numri total i vlerësuar i personave në trajtimin nga përdorimi i drogës (sipas llojit të drogës, gjinisë dhe moshës); Burimi i të dhënave: Raportet nga Ministria e shëndetësisë

P1.6: Prevalenca e përdoruesve problematikë të drogës, kryesisht PID të moshës 15 deri në 64 vjeç; Burimi i të dhënave: Ministria e shëndetësisë

Prioriteti strategjik 2: Reduktimi i oferrtës së drogave

Nëse:

- Sigurohet kryerja e detyrueshme e hetimeve financiare dhe konfiskimit të zgjeruar të pasurisë së autorëve të krimeve të drogës TP;
- Zbatimi i ndryshimeve ligjore për të ashpërsuar politikën e ndëshkimit;
- Fuqizimi i kapaciteteve të përgjithshme njerëzore dhe materialo-teknike të institucioneve kompetente që kanë funksion zbulues dhe funksion për parandalimin e TP me droga;
- Krijimi i mekanizmave efektivë për koordinim dhe komunikim ndërmjet institucioneve kompetente për parandalimin e drogës së TP në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Atëherë:

Do të forcohet zbatimi i legjislacionit në fushën penale për ndëshkimin e autorëve të krimeve që lidhen TP të drogave dhe do të përmirësohet politika e ndëshkimit dhe koordinimi i institucioneve.

Që do të çojë në:

Veprim efikas dhe efektiv i gjykatave, prokurorive publike dhe institucioneve përgjegjëse për reduktimin e tregtisë së palejuar të drogës, gjë që çon në uljen e ofertës së drogës.

Treguesit e suksesit për Prioritetin 2:

P2.1: Numri i konfiskimeve të drogave të paligjshme sipas llojit dhe sasisë; Burim i të dhënave: Raporte nga MPB dhe Drejtoria doganore

P2.2: Numri i raporteve fillestare të shkeljeve të ligjit për drogën, sipas llojit të drogës dhe llojit të veprimit të paligjshëm (furnizimi kundrejt përdorimit/posedimit); Burim i të dhënave: Raporte për zbatimin e nenit 19 të Ligjit për rendin publik, Ligjit për kontrollin e drogave dehëse, Kodit penal (nenet 215 dhe 216)

Prioriteti strategjik 3: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i koordinimit dhe komunikimit ndërmjet institucioneve kompetente në përputhje me praktikat dhe standardet e mira

Nëse:

- Përforcohen mekanizmat për menaxhim me politikat e drogës;
- Futen mekanizma dhe mjete efektive për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në përputhje me kërkesat e EMCDDA dhe Bashkimit Evropian;
- Të sigurohen mjete për financimin e politikave të drogës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Atëherë:

Do të përmirësohet koordinimi i përgjithshëm kombëtar dhe kapaciteti për të formuluar dhe zbatuar politikat e drogës.

Që do të çojë në:

Përgjigje efektive nga institucionet në trajtimin e problemit të drogës në RMV dhe respektimi i praktikave dhe standardeve të mira në këtë fushë.

Treguesit e suksesit për Prioritetin 3:

P3.1: Numri i të punësuarve në institucionet që punojnë në problematikat e lidhura me drogën (i ndarë sipas institucionit dhe sipas vitit; Burimi i të dhënave: Platforma e Ministrisë së shëndetësisë (Drug Monitoring Platform)

P3.2: Përqindja e totalit të buxhetit të nevojshëm për zbatimin e planeve të veprimit të siguruara nga fondet e huaja; Burim i të dhënave: Raportet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komisionit Ndërsektoral për luftën kundër drogave.

3. PRIORITETET STRATEGJIKE, SYNIMET, REZULTATET DHE MASAT

Prioriteti strategjik 1: Ulja e kërkesës për droga

Si pjesë e prioritetit të parë strategjik, Strategjia për drogë do të fokusohet në përmirësimin e parandalimit të përdorimit të drogës, uljen e stigmës dhe diskriminimit, sigurimin e cilësisë në trajtimin gjithëpërfshirës, uljen e dëmit dhe përmirësimin e qasjes në shërbime në të gjitha nivelet. Ky prioritet strategjik do të përmbushet duke arritur objektivat e mëposhtme strategjike , rezultatet dhe masat.

Qëllimi strategjik 1.1: Krijimi i një sistemi efektiv për parandalim të drogave në kuadër të arsimit dhe shëndetësisë në përputhje me praktikat e mira

Rezultatet e pritshme :

1.1.1 Të vendosura standardet nacionale për cilësinë e parandalimit

1.1.2 Planprograme mësimore dhe parandaluese të aplikuara të përshtatura sipas nevojave dhe të bazuara në kritere dhe standarde të njohura ndërkombëtarisht

1.1.3 Sistemi i krijuar parandalues është i integruar në sistemin arsimor dhe shëndetësor

Qëllimi strategjik 1.2 Programe cilësore për trajtimin e varësive nga droga bazuar në analizat që përfshijnë të gjithë personat sipas gjinisë, moshës dhe llojit të drogës që përdorin

Rezultatet e pritshme:

1.2.1 Standardet nacionale për cilësinë e trajtimit të zhvilluara dhe zbatuara

1.2.2 Legjislacioni në fushën e kujdesit shëndetësor parashikon trajtimin e duhur për çdo person

1.2.3 Programet dhe protokollet e disponueshme dhe të përshtatura për trajtimin e varësive nga droga bazuar në standarde dhe të në dëshmi për nevojat e PPD, si dhe programe për trajtimin e sëmundjeve të varësisë duke përdorur kanabisin mjekësor

Synimi strategjik1.3: Programet për reduktim të dëmit janë përmirësuar, janë të qëndrueshme dhe të përshtatura me nevojat e përdoruesve

Rezultatet e pritshme:

1.3.1 Legjislacioni në fushën e shëndetit dhe mbrojtjes sociale njeh PZD të cilat bazohen në standardet dhe normat e cilësisë dhe OShC-të si ofrues të shërbimeve brenda PZD.

1.3.2 PZD të disponueshme dhe qasshme e pershtatur sipas nevojave te PPD

Synimi strategjik1.4: Qasje e përmirësuar e PPD deri tek shërbimet sociale në nivel lokal

Rezultatet e pritshme :

1.4.1 Ofruesit e shërbimeve sociale në nivel lokal kanë në dispozicion kapacitetet e përshtatshme për ofrimin e shërbimeve

1.4.2 Rrjeti i zhvilluar i ofruesve të licencuar të shërbimeve në nivel lokal

Qëllimet dhe rezultatet e parashikuara nga ky prioritet strategjik do të arrihen nëpërmjet zbatimit të **masave dhe ndërhyrjeve** të mëposhtme:

- Përgatitja dhe zbatimi i standardeve nacionale të cilësisë për parandalimin dhe trajtimin bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të nevojave, në përputhje me standardet dhe praktikat pozitive evropiane. Përgatitja e standardeve të tilla do të zbatojë një proces të gjerë konsultativ, por edhe nxitjen e duhur të zhvillimit të tyre.
- Përshtatja dhe përmirësimi i programeve të parandalimit bazuar në analiza gjithëpërfshirëse të praktikave ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto programe do të përfshijnë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave për autorizimin e subjekteve për zbatim të programeve.
- Trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i profesionistëve dhe praktikantëve në fushën e parandalimit dhe trajtimit.
- Analizë e planprogrameve në kuadër të arsimit fillor dhe të mesëm në drejtim të integrimit të përmbajtjeve të përshtatshme për parandalim, trajnimin dhe zhvillimin e kuadrit arsimor, si dhe edukimin e bashkëmoshatarëve.
- Zbatimi i aktiviteteve për zvogëlimin e stigmës dhe diskriminimin.
- Futja e trajtimit cilësor të PÇPD që do të sigurojë raportin e duhur të PÇPD për ekip mjekësor, duke promovuar Ligjin për mbrojtje shëndetësore.
- Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të trajtimit nga varësitë nga droga që do të përshtaten sipas moshës dhe gjinisë me fokus të veçantë në programet adekuate për fëmijët nën 18 vjeç, modele të përshtatura dhe programe trajtimi në burgje, duke përfshirë programet për situatat me komorbiditete.
- Futja e përdorimit të barnave të reja dhe rritja e disponueshmërisë të buprenorfinës dhe naloksonit.
- Edukimi i personelit mjekësor për përdorimin e preparateve nga kanabisi në mjekim.
- Masat për afirmimin e përdorimit të kanabisit për qëllime mjekësore dhe disponueshmëri më të madhe të preparateve të kanabisit.
- Forcimi i rolit të OShC-ve si ofrues të shërbimeve në PZD duke avokuar për miratimin e ndryshimeve ligjore.
- Integrimi i PZD në legjislacionin, duke përfshirë përgatitjen e rregullt të strukturës financiare në baza vjetore dhe ndarjen e fondeve për këto programe.

- Licencimi i ofruesve të shërbimeve sociale në nivel vendor, duke promovuar kritere dhe procedura të qarta.
- Forcimi i kapaciteteve të subjekteve vendore si ofrues shërbimesh, duke përfshirë bashkëpunimin e qartë dhe efektiv, si dhe shkëmbimin e rregullt të informacionit.

Prioriteti strategjik 2: Reduktimi i ofertës së drogave

Në kuadër të këtij prioriteti, strategjia do të fokusohet në forcimin e zbatimit të legjislacionit për sanksionimin e krimeve që lidhen me tregtinë e drogës, përmirësimin e kapaciteteve dhe funksionalitetit të institucioneve përgjegjëse, si dhe forcimin e sistemit të informimit të ndërsjellë për të siguruar një koordinim efektiv dhe ndërhyrje adekuate. Ky prioritet strategjik parasheh objektivat strategjiketë mëposhtme, rezultatet dhe masat:

Synimi strategjik 2.1 Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit penal në lidhje me sanksionimin e autorëve të krimeve që lidhen me tregtinë e paligjshme dhe prodhimin e paautorizuar të drogave

Rezultatet e pritshme:

2.1.1 Legjislacioni siguron kryerjen e detyrueshme të hetimeve financiare ndaj autorëve të krimeve më të rënda në fushën e tregtisë së paligjshme të drogës.

2.1.2 Politika e përmirësuar e ndëshkimit dhe e ekzekutimit të sanksioneve për aktet e tregtisë së paligjshme të drogës

Qëllimi strategjik 2.2 Përmirësimi i funksionalitetit të institucioneve përgjegjëse për parandalimin e tregtisë së paligjshme të drogës

Rezultatet e pritshme:

2.2.1 Forcimi i kapaciteteve materiale dhe teknike në përputhje me nevojat dhe tendencat moderne për parandalimin e tregtisë së paligjshme të drogës

2.2.2 Forcimi i kapaciteteve të personelit sipas nevojave dhe sistematizimi i vendeve të punës dhe pozicioneve

Synimi strategjik 2.3. Përmirësimi i praktikave të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për parandalimin e tregtisë së palejuar me drogë

Rezultatet e pritshme:

2.3.1 Rregulloret aktuale ofrojnë komunikim dhe koordinim sistemik për shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për parandalimin e tregtisë së paligjshme të drogës

2.3.2 Krijimi i bazës së përbashkët të të dhënave në institucionet përgjegjëse për parandalimin e tregtisë së paligjshme të drogës

2.3.3 Mekanizmat funksionale për zbatimin e vazhdueshëm të rregullave dhe protokolleve për koordinim në punën e përditshme

Qëllimet dhe rezultatet për reduktimin e furnizimit me drogë do të arrihen nëpërmjet **masave dhe ndërhyrjeve të mëposhtme:**

- Masat për përmirësimin e legjislacionit për kryerjen e hetimeve të detyrueshme financiare dhe sigurimi i mbrojtjes për vendimmarrësit kryesorë.
- Analizë e vendimeve të gjykatës dhe prokurorisë, si dhe vendime për përzgjedhjen e institucioneve ndëshkimore -korrektuese për autorët e dënuar.

- Përgatitja e analizave dhe rekomandimeve për ndryshimin e Kodit penal (neni 215) në pjesën që rregullon prodhimin dhe shpërndarjen e paautorizuar të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve.
- Kryerja e një vlerësimi për pajisjet teknike të nevojshme si dhe prokurimi dhe përdorimi i i pajisjeve teknike për identifikimin e tregtisë së paligjshme të drogës në bazë të një vlerësimi paraprak teknik për nevojat.
- Vlerësimi i nevojave dhe punësimi i personelit të ri si dhe trajnimi dhe fuqizimi i burimeve ekzistuese njerëzore në institucionet për parandalimin dhe zbulimin e TP me drogë.
- Harmonizimi me rregulloren evropiane në lidhje me promovimin e komunikimit ndërsektorial, futja e zgjidhjeve funksionale softuerike si dhe forcimi i kuadrit për zbatimin e mjeteve dhe kanaleve të reja të komunikimit që do të përfshijnë bazat e të dhënave dhe zgjidhjet softuerike.
- Prezantimi i ekipeve multi-sektoriale të shkëmbimit të informacionit, duke siguruar konfidencialitet dhe besim.

Prioriteti strategjik 3: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i koordinimit dhe komunikimit ndërmjet institucioneve kompetente në përputhje me praktikat dhe standardet e mira

Qëllimi strategjik 3.1 Funksionaliteti i forcuar i sistemit të menaxhimit të politikave mbi drogë

Rezultatet e pritshme:

3.1.1 Komisioni ndërsektoral përcakton dhe paraqet rekomandime të bazuara në kërkime dhe dëshmi për vendim-marrësit

3.1.2 Përmirësimi kadrovik i personelit, njohurive dhe aftësive për zbatimin e politikave të drogës të Qendrës për monitorim të drogave në kuadër të Sektorit për kimikate dhe substanca të kontrolluara pranë Ministrisë së Shëndetësisë e cila kryen veprimtarinë e Qendrës për monitorim të drogave dhe varësisë nga droga (në tekstin e mëtutjeshëm Qendra), si dhe në institucionet kompetente në fushën e drogave

3.1.3 Futja e mekanizmave funksionalë për monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe planeve për veprim

Synimi strategjik 3.2 Përmirësimi i cilësisë së sistemit të raportimit tek institucionet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe publikut

Rezultatet e pritshme:

3.2.1 Vendosja e sistemit funksional të raportimit për EMCDDA dhe institucionet përkatëse ndërkombëtare bazuar në informata dhe të dhëna përkatëse dhe në përputhje me standardet e raportimit

3.2.2 Informata të përditësuara dhe përkatëse të disponueshme mbi çështjet dhe politikat e drogës në nivel kombëtar

Qëllimi strategjik 3.3 Rritja e burimeve financiare për zbatimin e politikave dhe programeve të drogës

Rezultatet e pritshme:

3.3.1 Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile dhe një qasje e koordinuar për mbledhjen e fondeve

3.3.2 Rritja e qasjes në fonde nga organizatat ndërkombëtare, buxheti publik në nivel lokal, sektori privat dhe individët

Qëllimet dhe rezultatet për forcimin e mëtejshëm të koordinimit, kapaciteteve dhe komunikimit ndërmjet institucioneve do të arrihen përmes **masave dhe ndërhyrjeve** të mëposhtme:

- Përcaktimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore për përmirësimin e legjislacionit, përgatitja e propozimeve për ndryshime dhe përfaqësimi i tyre para institucioneve.
- Përgatitja e propozimeve dhe rekomandimeve për caktimin e mjeteve të cilat subjektet juridike prodhuese të kanabisit i paguajnë në buxhetin e RMV.
- Vlerësimi i nevojave për punësime në Qendrën dhe në institucione të tjera, avokimi i planit për punësime të reja para institucioneve, përgatitja e planit për trajnim dhe zhvillim për stafin dhe monitorim të zbatimit të planeve.
- Krijimi i rrjetit të ekspertëve dhe grupeve të punës për raportim në përputhje me rekomandimet e EMCDDA: Grupi i punës për Përdorimin e drogës në popullsinë e përgjithshme dhe në mes të rinjve - General Population Survey (GPS), për vdekjet e shkaktuara nga droga - Drug related deaths (DRD), për përdorimin e drogave me rrezik të lartë - high-risk drug use (HRDU); për sëmundjet infektive të lidhura me përdorimin e drogës - drug-related infectious diseases (DRID); dhe për treguesin e kërkesës për trajtim - treatment demand indicator (TDI).
- Kryerja e vlerësimeve të jashtme për të vlerësuar efektet e strategjisë.
- Pajisja teknike e Qendrës , fuqizimi i laboratorëve ekzistues dhe marrja e akreditimeve dhe licencave të reja për testimin e drogave dhe substancave.
- Përgatitja e regjistrit funksional të sëmundjeve të varësisë dhe regjistrave të tjerë në përputhje me kërkesat e EMCDDA.
- Kryerja e analizave dhe kërkimeve kombëtare për të monitoruar tendencat dhe ndryshimet në fushën e kërkesës dhe ofertës së drogave, si ESPAD, GPS, TQS, etj.
- Krijimi dhe përditësimi i rregullt i një ueb faqeje të veçantë dhe promovimi i rezultateve dhe gjetjeve nga analizat, raportet, kërkimet, etj.
- Përcaktimi i prioriteteve të përbashkëta të financimit, përgatitja e planit për mbledhjen e fondeve dhe prezantimi i planit tek BE-ja dhe donatorëve të tjerë.
- Avokim për rialokimin e fondeve nga akciza për birrën, cigaret dhe alkoolin etilik me qëllim të zbatimit të programeve për parandalimin, trajtimin e NS.
- Avokim me qëllim të sigurimit të mbështetjes financiare për masat e strategjisë dhe në kuadër të buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Organizimi i ngjarjeve për mbledhjen e fondeve dhe promovimi i strategjisë.

4. KORNIZA LIGJORE DHE DOKUMENTET STRATEGJIKE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Në RMV, më shumë ligje dhe akte nënligjore mbulojnë drogat dhe veprimet për parandalimin e prodhimit të paligjshëm të drogave, trafikut të paligjshëm me droga, mbrojtjen e shëndetit, integrimin e PPD në shoqëri dhe ngjashëm, ku ligjet kryesore janë: Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope, Ligji për prekursorët, Ligji doganor, Kodi penal, Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Ligji për kujdesin shëndetësor, Ligji për mbrojtjen sociale, etj.

RMV ka ratifikuar disa konventa ndërkombëtare në këtë sferë: Konventa e vetme e Kombeve të Bashkuara për drogat narkotike nga 1961 (e plotësuar me protokollin nga viti 1972), Konventa mbi substancat psikotropike nga 1971, Konventa kundër shitjes së paligjshme të drogave narkotike dhe substancave psikotropike nga viti 1988, Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut si dhe deklarata, statute dhe rregullore të tjera të shumta.

Strategjia kombëtare për drogat është miratuar në përputhje me nenin 19 të Ligjit për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike dhe Planin e veprimit për zbatimin e strategjisë në përputhje me nenin 20 të të njëjtit ligj. Në fund të vitit 2006 u miratua Strategjia e parë kombëtare për droga, ndërsa plani i veprimit u miratua në vitin 2007. Strategjia e parë për droga në Republikën e Maqedonisë, e cila mbuloi periudhën 2006-2012, u theksuan përpjekjet, të cilat rikonfirmohen me strategjinë e re për periudhën 2014-2020, për një qasje të balancuar në zbatimin e të gjitha pjesëve të strategjisë dhe të gjithë elementët që lidhen me problemin e drogave, bazuar në njohuritë e evidentuara nga praktika, por edhe duke kryer kërkime shkencore dhe vlerësim të situatës, me qëllim të përcaktimit të masave për tejkalimin e tyre.

Në vitin 2008, Këshilli i Qytetit të Shkupit miratoi Strategjinë e parë lokale për droga

të Qytetit të Shkupit për periudhën 2008-2013, së bashku me planin lokal të veprimit, dhe më pas u miratua edhe strategjia për periudhën 2015-2020 me planin e veprimit për 2015/2016. Përveç Shkupit, edhe Komuna e Strumicës ka përgatitur dhe miratuar Strategjinë lokale për droga.

Në kuadër të Ministrisë së shëndetësisë, por edhe në institucionet tjera kompetente në fushën e drogave, përgatiten dhe zbatohen një sërë programesh përmes të cilave trajtohen aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me pasojat e përdorimit të drogës, duke përfshirë trajtimin e varësisë nga droga, mbrojtjen e popullatës nga HIV, shëndeti publik, shëndeti mendor, çrregullimet, kujdesi shëndetësor dhe sigurimi, mbrojtja sociale, risocializimi dhe riintegrimi, etj.

Për shkak se është një politikë shumësektoriale, tema e drogës trajtohet në dokumente të tjera strategjike, si Strategjia kombëtare për rininë, Strategjia kombëtare për HIV-in, dokumentet strategjike të MPPS-së, MPB-së dhe të ngjashme.

5. INSTITUCIONET, AKTORËT DHE PËRDORUESIT PËRFUNDIMTARË NË POLITIKAT KOMBËTARE PËR DROGA

Institucioni kyç në sistemin e menaxhimit të politikave të drogave është Ministria e shëndetësisë (MSH) si institucion përgjegjës dhe kompetent në radhë të parë në zbatimin e Ligjit për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope. Ministria është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin pranë institucioneve ndërkombëtare dhe evropiane, dhënien e miratimeve për kultivimin e kanabisit për qëllime mjekësore, kryesimin me Komisionin shtetëror ndërinstitucional për Luftën kundër drogave, ka një rol kyç në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe është një negociator aktiv në Kapitullin 24: Drejtësia, liria dhe siguria nga Komisioni Evropian. Ministria, gjegjësisht Qendra për monitorimin e drogave dhe varësisë nga drogat, e cila funksionon në kuadër të Sektorit të substancave të kontrolluara, është pikë kontakti për koordinim me Qendrën Evropiane për monitorimin e drogave dhe varësive nga droga (EMCDDA), si dhe për rrjetin për droga dhe varësi nga droga - Reitox. Instituti i Shëndetit Publik punon për të promovuar shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të popullatës nëpërmjet njohurive të bazuara në shkencë, praktikave të mira, informacioneve dhe partneriteteve organizative dhe ndikimit

të politikave të qëndrueshme të shëndetit publik. Qendrat për trajtimin dhe parandalimin e drogës janë institucione kyçe për trajtimin dhe parandalimin e përdorimit të drogës, si dhe Fakulteti i Mjekësisë, ku arsimohen kuadrot.

Ministria e punëve të brendshme, së bashku me Drejtorinë doganore, janë një nga aktorët kryesorë në funksionin e zbulimit në proceset e luftimit të trafikut të paligjshëm të drogës. MPB, si anëtare e komisionit ndërinstitucional, ka një ndikim të madh në krijimin e politikave dhe programeve për ndërhyrjet lidhur me zvogëlimin e furnizimit me droga. Gjithashtu, MPB ka krijuar bashkëpunim me faktorët vendas dhe ndërkombëtarë në drejtim të raportimit, koordinimit dhe shkëmbimit të praktikave të mira në luftimin e tregtisë së paligjshme. Ndër të tjera, DD-ja është përgjegjëse për zbatimin e masave të kontrollit doganor, masat hetimore dhe të inteligjencës me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të kundërvajtjeve dhe krimeve doganore.

Ministria e punës dhe politikës sociale është një lojtar kyç në zbatimin e programeve dhe masave në lidhje me risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin. MPPS ka ndikim të madh në krijimin e politikave për drogat, merr pjesë në komisionin ndërinstitucional për luftë kundër drogës, por edhe vendos koordinim në nivel rajonal dhe lokal lidhur me ofrimin e shërbimeve për PPD. Në kuadër të veprimtarisë sociale, institucionet publike ndërkomunale - qendrat për punë sociale kanë kompetenca në ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale, ndihmës financiare dhe shërbimeve sociale. Gjithashtu ka edhe objekte akomodimi si ofrues të shërbimeve në fushën e kujdesit, mbrojtjes dhe trajtimit psikosocial që kontribuojnë në deinstitucionalizimin. Sa i përket riintegrimit, rol kyç kanë Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe qendrat e punësimit nëpër komuna.

Institucionet në fushën e së drejtës dhe drejtësisë, si Ministria e drejtësisë (MD), Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, gjykatat, prokuroritë publike, janë përgjegjëse për përgatitjen e legjislacionit në këtë fushë, përkatësisht për kryerjen dhe zbatimin e ligjit dhe drejtësisë në pajtim me dispozitat ligjore të përcaktuara. Parimi i bazuar në të drejtat e njeriut, mosdiskriminimin dhe gjykimin e drejtë është i një rëndësie të veçantë në këto institucione.

Në aspektin e parandalimit përmes edukimit të të rinjve, aktorët kryesorë janë Ministria e arsimit dhe shkencës, si dhe organet në kuadër të ministrisë, si Byroja për zhvillimin e arsimit dhe Qendra për arsim dhe aftësim profesional. Këto institucione kanë një ndikim të madh në planifikimin dhe zbatimin e politikave të drogës, veçanërisht në pjesën e përshtatjes së kurrikulave në arsimin fillor dhe të mesëm për parandalimin e përdorimit të drogës. Gjithashtu, si një institucion që mund të kontribuojë në edukimin mbi pasojat e abuzimit me drogën është Agjencia për rininë dhe sportin, e cila është koordinatore për zbatimin e Strategjisë kombëtare për rininë 2016-2025 dhe përmban një segment që synon ofrimin e kushteve për rehabilitim të qetë dhe risocializimi i kategorive të cënueshme të të rinjve.

Sektori i shoqërisë civile ka një rol të madh për të luajtur në planifikimin dhe zbatimin e politikave të drogës, veçanërisht në uljen e kërkesës. Sektori i shoqërisë civile është dukshëm i pranishëm dhe aktiv në zbatimin e PZD. Veçanërisht aktive në çështjen e drogës janë Platforma e HIV-it si një rrjet prej 16 OSHC-ve përkatëse që ofrojnë shërbime për parandalimin e HIV-it, si dhe kujdesin dhe mbështetjen për grupet që janë në rrezik të veçantë të virusit dhe Rrjeti për reduktimin e dëmit të krijuar për të kontribuar në reduktimin e dëmeve nga përdorimin të drogës. Rrjeti bashkon të gjitha organizatat që punojnë PZD dhe kanë në dispozicion ekspertizë të madhe.

PPD dhe PÇPD janë përfituesit kryesorë të efekteve të kësaj strategjie dhe kanë nevojë dhe interes të përmirësojnë situatën e tyre, duke pasur një ndikim të vogël në proceset e politikave për droga. Përvojat dhe praktikat e tyre, si dhe ato të familjeve të tyre, mund të kontribuojnë shumë në përcaktimin e politikave të përshtatura cilësore për droga. Profesionistët në fushën e varësive veprojnë në drejtim të përmirësimit të përgjithshëm të kushteve të punës, kanë ekspertizën dhe njohuritë e duhura për këtë çështje. Megjithatë, ka nevojë për rritjen e stafit profesional për të ruajtur fushëveprimin dhe qasjen për të punuar në çështje të tilla.

6. KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË STRATEGJISË ME PUBLIKUN

Komunikimi i rezultateve të strategjisë me publikun do të bëhet përmes disa llojeve të mjeteve:

Faqja e internetit – Është planifikuar të përgatitet dhe rregullisht të përditësohet një faqe interneti në të cilën do të

vendosen informacione përkatëse, si nga fusha e drogave, ashtu edhe hulumtime, analiza dhe studime që tregojnë trendet. Në faqen e internetit do të prezantohen edhe raportet e dorëzuara nga RMV tek institucionet ndërkombëtare.

Raporte për institucionet ndërkombëtare - Në kuadër të forcimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit, është planifikuar të përgatiten raporte sipas treguesve të vendosur që duhet të jenë në dispozicion në një formë të caktuar dhe të informohet publiku.

Raportet vjetore të ministrive dhe institucionet tjera - Në kuadër të raportimeve të rregullta vjetore të kryera nga ministritë dhe institucionet tjera kompetente në fushën e drogave, parashihet të përfshihen informacione nga kjo fushë.

Deklarata dhe konferenca për shtyp - Në pajtim me nevojën për të informuar publikun për çështje të rëndësishme, si dhe për të prezantuar dhe promovuar aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura, do të organizohen konferenca për shtyp dhe takime me media.

Aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile - Në kuadër të punës së organizatave të shoqërisë civile përmes aktiviteteve të tyre do të informojnë publikun dhe grupet e synuara për aktivitetet dhe rezultatet që janë arritur, dhe janë pjesë e strategjisë.

7. BURIMET E FINANCIMIT

Financimi i strategjisë është planifikuar në kuadër të buxheteve të pranuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e strategjisë dhe përmes planifikimit të rregullt të aktiviteteve nga planet e veprimit për zbatimin e strategjisë në programet dhe planet vjetore të institucioneve.

Me mbështetjen e ministrive kompetente dhe Qeverisë, do të kërkohen dhe do të programohen fonde në kuadër të IPA 3, si dhe fonde të tjera në dispozicion nga BE-ja. Gjithashtu është planifikuar edhe qasje ndaj organizatave të rëndësishme ndërkombëtare për të siguruar fondeve për zbatimin e strategjisë, si dhe mbështetje nga ana e tyre për forcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe Qendrës për monitorimin e drogave.

Organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet kompetente në fushën e drogave planifikojnë një prezantim të përbashkët të çështjeve prioritare tek donatorët ndërkombëtarë për të siguruar fonde për financimin e prioriteteve të strategjisë.

PLAN I VEPRIMIT PËR PERIUDHËN 2021-2023 PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NACIONALE PËR DROGAT

Shkup, maj 2021

LISTA E SHKURTESAVE

APRMV	Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut
GPS-ja e drogave	Përdorimi i substancave psikoaktive tek popullata e përgjithshme në Republikën e Maqedonisë, raport nga hulumtim
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
EMCDDA (Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Drogat)	Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësitë nga Drogat
ESPAD (European School Survey Project on Alcohol and Other Drugs)	Projekt i sondazhit në shkollat për përdorimin e alkoolit dhe drogave të tjera
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KP	Kodi Penal
PID	Personat që injektojnë drogë
PPD	Persona që përdorin drogë
PÇPD	Persona me çrregullim nga përdorimi i drogës
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
QMDVD	Qendra për Monitorimin e Drogës dhe Varësinë nga Droga
TI	Tregti ilegale
TOA	terapi me opioid agonist
GOK	Grupe të organizuara kriminale
PRD	Programi për reduktimin e dëmeve
SP	Substancat psikoaktive
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
KB (United Nations)	Kombet e Bashkuara
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
HIV	Virusi i mungesës së imunitetit të njeriut
HOPS - OJQ HOPS	Opsione për jetë të shëndetshme
DD	Drejtoria e Doganave
SRP	Substancë e re psikotrope

Terminologjia

Njerëzit me çrregullime nga përdorimit i drogës - Termi është në përputhje me standardet e OBSH-së. Ai do të përdoret kudo në tekst, me përjashtim të pjesëve që citohen dhe ku fillimisht janë përdorur terme si të varur, i varur, përdorues etj.

Për kanabisin, marihuanën dhe kërpin, kanabis do të përdoret si një term i përbashkët. Duke vepruar kështu, forma origjinale e termave të tjerë të përmendur si marihuanë ose kërp do të ruhet në ato vende ku citohen raportet dhe dokumentet.

Organizatat e shoqërisë civile janë shoqata, fondacione, sindikata, si dhe çdo formë organizative e një organizate të huaj, si dhe forma të tjera të asocimit, të regjistruara në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë së drogës përfshin tre vitet e para, 2021-2023, të periudhës pesëvjeçare të parashikuara për zbatimin e Strategjisë. Ky plan e ndjek plotësisht kornizën e Strategjisë në aspektin e prioriteteve të përcaktuara strategjike, qëllimeve strategjike dhe rezultateve afatshkurtra, gjegjësisht rezultate të parashikuara në Strategjinë. Periudha e parë trevjeçare mbulon tre prioritetet strategjike, si dhe të gjitha qëllimet dhe rezultatet e pritura, por aktivitetet e planifikuara kryesisht i referohen vetëm një segmenti të rezultateve dhe synimeve të planifikuara që pritet të përmbushen në këtë periudhë strategjike.

Ky plan, edhe pse në dukje ambicioz, përfshin të gjitha aktivitetet prioritare që duhet të zbatohen për të treguar ndryshimet fillestare pozitive dhe progresin në fushën e politikave dhe aktiviteteve të lidhura me drogën në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përfaqësues të institucioneve kyçe relevante dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) morën pjesë në hartimin e planit si anëtarë të caktuar të grupit punues për përgatitjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, të cilët punuan me përkushtim përmes diskutimeve dhe seminareve për zhvillimin e të gjitha elementeve të planit.

Plani përmban tre prioritete strategjike:

Prioriteti 1: Ulja e kërkesës për drogë

Prioriteti 2: Ulja e furnizimit të drogës

Prioriteti 3: Zhvillimi i mëtejmë i kapaciteteve dhe përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve kompetente në përputhje me praktikat dhe standardet e mira

